



FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE  
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO  
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

# RAPORTI VJETOR

# 2022



FONDI KOSOVAR PËR GARANTIMIN  
KOSOVSKI FOND ZA GARANTIMIN  
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

# PËRMBAJTJA

<b>04</b>	<b>PJESA I - INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME</b>
06	FJALA E KRYESUESIT TË BORDIT DHE E DREJTORIT MENAXHUES
10	AKRONIMET
11	PËRMBLEDHJE E TREGUESVE OPERACIONALË
<hr/>	
<b>12</b>	<b>PJESA II - PROFILI I INSTITUCIONIT</b>
14	THEMELIMI DHE STATUSI I FKGK-SË
14	MISIONI
15	VLERAT INSTITUCIONALE
16	AECM – ASOCIACIONI EVROPIAN I INSTITUCIONEVE GARANTUESE
<hr/>	
<b>18</b>	<b>PJESA III - QEVERISJA KORPORATIVE</b>
20	BORDI I DREJTORËVE DHE PERSONELI
21	STRUKTURA ORGANIZATIVE
22	KORNIZA LIGJORE
23	BASHKËPUNËTORËT
24	KOMITETET
24	KOMITETI I MENAXHIMIT TË RISKUT
24	KOMITETI I AUDITIMIT
25	TAKIMET E BORDIT TË DREJTORËVE DHE TË KOMITETEVE PËRKATËSE
<hr/>	
<b>26</b>	<b>PJESA IV - PERFORMANCA E FKGK-SË</b>
28	ZHVILLIMI I PORTOFOLIT TË GARANCIVE
30	DRITARJA AGRO - ZHVILLIMI DHE RISITË
32	SHTUESHMËRIA
35	MENAXHIMI I RISKUT KREDITOR
36	PARANDALIMI I PASTRIMIT TË PARAVE DHE LUFTIMI I FINANCIMIT TË TERRORIZMIT
38	KUALITETI I PORTOFOLIT
40	STRUKTURA E KAPITALIT
40	INVESTIMET E KAPITALIT
42	QEVERISJA MJEDISORE DHE SOCIALE
<hr/>	
<b>46</b>	<b>PJESA V - VEÇORITË E VITIT 2022</b>
48	NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI I LIGJIT NR.05/L-057 PËR THEMELIMIN E FKGK-SË
48	LANSIMI I DRITARES GROW
49	LANSIMI I DRITARES SË EKSPORTIT
49	FILLON IMPLEMENTIMI I PROJEKTIT ME EIB
<hr/>	
<b>52</b>	<b>PJESA VI - AKTIVITETET GJATË VITIT 2022</b>
54	AKTIVITETET 2022
67	STORIE SUKSESI
<hr/>	
<b>70</b>	<b>PJESA VI - PASQYRAT FINANCIARE TË AUDITUARA</b>



# PJESA I



# INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME



# FJALA E KRYESUESIT TË BORDIT DHE E DREJTORIT MENAXHUES

Kemi kënaqësinë që me raportin vjetor të radhës t'i ndajmë me Ju të arriturat dhe sfidat e institucionit tonë përgjatë vitit të kaluar 2022, njëherazi, të shpalosim planet dhe objektivat për vitet e ardhshme. Për te shtatën herë radhazi, raporti vjetor i FKGGK-së do të ketë në fokus ndarjen e informatave që tregojnë ndikimin që skemat garantuese të institucionit tonë kanë në ekonominë e vendit.

Viti 2022 ishte vit i veçantë për institucionin tonë, sepse portofolit të dritareve garantuese iu shtuan edhe dy dritare të reja, Dritarja e Gjellbër – GROW, ndërsa në pjesën e dytë të vitit zyrtarizuar lansimin e Dritares së Eksportit. Dritarja e parë - për të ndihmuar investimet e gjelbra për NMVM-të, ndërsa e dyta, për të mbështetur investimet e ndërmarrjeve eksportuese. Derisa besojmë që së shpejti, pas një pune intensive të stafit të FKGGK-së, përgjatë vitit të kaluar, në pjesën e parë të vitit 2023, do të fillojmë edhe me dy dritare të tjera: Dritaren që mbështet Gratë në Biznes dhe dritaren që mbështet ndërmarrjet "Start-up".

Po në vitin 2022, ne kemi filluar edhe implementimin e projektit "Reagimi i Kosovës ndaj Pandemisë COVID-19 për NMVM-të". Është ky një bashkëpunim midis Bankës Botërore dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, që ka filluar qysh në vitin 2021, ndërsa është konkretizuar në muajin tetor të vitit 2022, e që si qëllim ka rritjen e kapitalit të FKGGK-së deri në 40 milionë euro. Si rrjedhojë, kjo iniciativë do të rritë kapacitetin garantues të FKGGK-së dhe do të sjellë më shumë mundësi për kreditim të NMVM-ve.

Listës së risive gjatë vitit të kaluar, i shtohet edhe amendamenti i Ligjit për Themelimin e FKGGK-së, i pari ndryshim i ndodhur që nga themelimi i institucionit. Ndonëse në fundament ligji mbetet i pandryshuar dhe u përmbahet parimeve bazë të vendosura nga themeluesit e institucionit, amendamentet e reja janë reflektim i nevojave të tregut dhe reagimeve nga partnerët tanë, përgjatë përvojës së tyre me FKGGK-në. Amendamentet e reja të LTHFKGGK-së, do t'i mundësojnë institucionit më shumë fleksibilitet gjatë procesit

të garantimit kreditor, si dhe përgjigje më adekuate nevojave të ndërmarrjeve private. Në mesin e disa amendamenteve të përfshira në LTHFKGK-së, ia vlen të përmenden dy prej tyre si më të rëndësishmet: e para është mundësimi i garantimit kreditor për fermerët e vegjël të identifikuar me numër fermeri; dhe e dyta, rritja e mbulueshmërisë me garancinë, deri në 80%, në raste kur vlerësohet që një rritje e tillë është më se e nevojshme për segmente të caktuara të tregut.

Që të dyja këto ndryshime kanë gjetur menjëherë përdorim në kuadër të dritareve garantuese të FKGGK-së. Mundësia e garantimit të fermerëve është reflektuar me modifikimet e fundit në marrëveshjen e garancisë së dritares së agros, ndërsa rritja e mbulueshmërisë me garancion do të jete veçoria kryesore dalluese e Dritareve Gratë në Biznes dhe asaj Start-up.

Rritja e vlerës maksimale të garancionit kreditor nga 250K në 500K, dhe vlerës së kredisë së garantuar nga 1 milion euro në 3 milionë, është po ashtu një mundësi tjetër më shumë në dritaret tona garantuese. Duke u mundur të jemi të kujdesshëm dhe të matur në procesin e menaxhimit të riskut kreditor, kjo rritje është bërë në kohën kur institucioni ka vlerësuar se tanimë ka një bazë të fortë të kapitalit, ka arritur nivel të kënaqshëm të diversifikimit të riskut në nivel të portofolit, si dhe ka krijuar përvojën e nevojshme brenda institucionit për menaxhimin e riskut kreditor.


Viti pas viti, dritare pas dritare, dhe projekt pas projekti, FKGGK-ja për të gjashtin vit radhazi, ka kontribuar për një ambient më të mirë të të bërit biznes në vendin tonë, duke u dëshmuar edhe një herë si faktor i rëndësishëm në zhvillimin e qëndrueshëm të ndërmarrësisë private, dhe partner i besueshëm i bankave gjatë procesit të ndërmjetësimit financiar.

Instrumentet financiare të FKGGK-së, të ashtuquajtura DRITARE, mbase jo shumë të dukshme nga përfituesi i fundit, megjithatë shumë produktive dhe të dobishme, me vet faktin se deri në vitin 2022 kanë përfituar: rreth 8,800 biznese kosovare; janë garantuar mbi 506 milionë euro të shpërndara në afërsisht 12,000 kredi, ndërsa pjesëmarrja e portofolit kreditor aktiv të garantuar në raport me total portofolin aktiv kreditor, në sektorin financiar, në segmentin NMVM-ve është afërsisht 15%.

Derisa tani me dritaret e disanjuara për segmente të caktuara të tregut, si: eksporti; investimet e gjelbra; agro; dhe së fundi në pritje për t'u aktivizuar edhe dritarja "Gratë në Biznes" dhe "Start-up", ndikimi ynë pritet të jetë edhe më i madh, më gjithëpërfshirës dhe më i qëndrueshëm, për të gjitha palët e përfshira në procesin e ndërmjetësimit financiar.

Zhvillimi pozitiv i institucionit tonë, dhe ndikimi që ky zhvillim ka pasur në ekonominë reale, mund të shihet në të gjithë treguesit kryesorë që portretizojnë shtueshmërinë financiare dhe ekonomike. Me 2,021 kredi të garantuara gjatë vitit 2022, kanë përfituar 1,750 ndërmarrje private. Me një pjesëmarrje prej 1.3% të vlerës aktive të garancive aktive në raport me bruto prodhimin kombëtar, gjatë vitit 2022, si indikator që tregon intensitetin e ndërmjetësimit financiar nga skemat garantuese, Kosova renditet më së miri nga të gjitha vendet e rajonit, me ç'rast vlera e këtij indikatori në nivel rajonal nuk kalon 1.1%. Me 16.7%, sipas Shoqatës së Skemave Garantuese Evropiane-AECM, Kosova edhe me këtë indikator tregon që instrumenti i garancioneve kreditore ka gjetur përdorim të theksuar në vendin tonë, dukshëm më mirë sesa në vendet fqinje, e ilustruar në hartën në vijim.

Harta e mbulueshmërisë së NMVM-ve aktive, që kanë përfituar nga garancionet kreditore.



Burimi: AECM - Vjetari Statistikor 2022

Pjesëmarrja e klientëve të rinj, që në saje të mbështetjes së garancioneve kreditore nga FKGK-ja, për herë të parë kanë krijuar relacione kreditore me banka, arriti në 15% nga numri total i të gjitha kredive të reja në sektor.

Kërkesa për kolateral, si një nga barrierat kryesore në kreditimin e NMVM-së, qoftë për klientët e rinj apo edhe për ata ekzistues, është ulur ndjeshëm për kreditë e garantuara krahasuar me kreditë e pagantuara. Vetëm gjatë vitit të kaluar kemi vërejtur që një përqindje e theksuar e klientëve të kredituar kanë qenë të kolateralizuar me më pak se 100% të vlerës së kredisë, derisa 37% apo 745 kredi nga të gjitha kreditë janë lëshuar pa pasur nevojë të plasojnë kolateral fare.

Jo më pak e rëndësishme për t'u përmendur është qasja jonë në menaxhimin e riskut ambiental dhe shoqëror, nga investimet e mundësuara nga garancionet kreditore në kuadër të dritareve të FKGK-së. Në këtë drejtim, në vazhdimësi ne rishikojmë listën e aktiviteteve përjashtuese, duke u munduar që të shmangim ndërmjetësimin tonë dhe partnerëve tanë, në financimin e aktiviteteve ekonomike dhe investimeve që kategorizohen me risk të lart ambiental apo shoqëror.

Për më shumë, duke filluar nga viti i kaluar, ne kemi filluar edhe me kuantifikimin e ndikimit në ambient, të portofolit tonë të garancioneve kreditore aktive duke përdorur metodologjinë

e Partneriteti për Matjen Zyrtare të Karbonit. Ndonëse jemi ballafaquar me mungesë të informatave kualitative në nivel të vendit, ne kemi filluar të llogarisim rezultate shumë domethënëse për eksternalitetet e shkaktuara nga ky portfol i investimeve. Duke shpresuar që gjatë muajve të ardhshëm do të avancojmë edhe më shumë me këtë metodologji të kalkulimit, rezultatet nga këto analiza do të jenë shumë të rëndësishme në vlerësimin se cilët sektorë krijojnë rritje të qëndrueshme ekonomike, duke balancuar këtë rritje me një menaxhim sa më të qëndrueshëm të resurseve natyrore dhe ndikim sa më të vogël në ambientin ku jetojmë.

Ndërsa në kuadër të Dritares së Gjelbër, kemi filluar ta monitorojmë për së afërmi ndikimin direkt të investimeve të gjelbra, në kuadër të Dritares GROW, në reduktimin e emetimit të CO<sub>2</sub> në atmosferë. Ndonëse ende jemi në fazën pilotuese të kësaj dritareje, nga fillimet e saj e deri më sot, me investimet e garantuara në kuadër të dritares së gjelbër – GROW, është mundësuar 5,000 tonë më pak CO<sub>2</sub> në atmosferë, si dhe 35% rritje e efikasitetit në konsumin e energjisë.

FKGK-ja vazhdon të mbetet një nga depozitorët më të mëdhenj në sektorin bankar në Kosovë. Edhe vitin e kaluar, sikur në vitet e mëhershme, strategjia e investimeve të FKGK-së, në masën më të madhe, është e orientuar në formë të







depozitave afatshkurtra dhe afatmesme në bankat vendore. Kjo qasje institucionale pasqyron besimin në partneritetin e krijuar mes FKGK-së dhe sektorit bankar në vendin tonë. Padyshim, kjo ka rritur likuiditetin në treg, dhe rrjedhimisht edhe kapacitetin kreditues të bankave vendore.

Ne u përpoqëm të përmbledhim shkurtimisht vetëm disa nga të arriturat dhe aktivitetet më të rëndësishme të FKGK-së, që kanë ndodhur gjatë vitit të kaluar. Në pamundësi që në këtë seksion t'i përmendim edhe shumë aktivitete dhe të arritura të tjera, besoj që lexuesi do të mund të gjejë hollësi të tjera në seksionet e veçanta të raportit, që trajtojnë menaxhimin e portofolit, riskut kreditor, performancën financiare të institucionit dhe shtueshmërinë ekonomike dhe financiare.

Edhe këtë vit, jemi të bindur që raporti vjetor i ofron lexuesit shumë informata, sepse institucioni ynë përgjatë tërë vitit 2022, me aktivitetet dhe angazhimin e tij, kishte çfarë t'u ofronte shoqërisë, ekonomisë, sektorit privat dhe sektorit financiar të vendit tonë.

## **ARTA HOXHA**

U.D. Kryesuese e Bordit

Këto të arritura na bëjnë krenarë, mirëpo në të njëjtën kohë edhe shumë përgjegjës dhe të kujdesshëm për hapat e ardhshëm në zhvillimin e institucionit të FKGK-së. Përgjegjës, sepse e kemi parë që rritja e shpejtë e institucionit nënkupton edhe sfida të brendshme në menaxhimin e kësaj rritjeje, duke veçuar adaptimin e proceseve interne dhe avancimin e njohurive brenda institucionit. Ndërsa të kujdesshëm, sepse jemi duke jetuar një kohë të paparashikueshme me kriza të njëpasnjëshme ekonomike dhe shoqërore në mbarë globin, që padyshim, ekonomia e vendit tonë as nuk është kursyer, dhe as nuk do të kursehet prej tyre. Prandaj, është shumë me rëndësi që strukturat udhëheqëse të kujdesen që ta forcojnë dhe ta konsolidojnë edhe më shumë institucionin e FKGK-së. Ngritja e njohurive dhe fuqizimi i kapaciteteve humane, përmes trajnimeve të vazhdueshme të stafit; menaxhimi i riskut kreditor dhe agjiliteti i proceseve të brendshme, duhet të jenë vetëm disa nga prioritetet afatmesme të strategjisë institucionale.

Duke besuar që jemi në rrugën e duhur, na lejoni që për fund, në emër të Bordit të Drejtorëve dhe stafit të FKGK-së, t'i falënderojmë të gjithë donatorët dhe partnerët tanë për mbështetjen e vazhdueshme dhënë FKGK-së. Mbështetja dhe besimi i dhënë nga ta është motiv shtesë për ne, për ta fuqizuar edhe më shumë institucionin tonë dhe për të arritur rezultate të tjera.

## **BESNIK BERISHA**

Drejtor Menaxhues

# AKRONIMET

<b>ARBK</b>		AGJENCIA PËR REGJISTRIMIN E BINESEVE TË KOSOVËS
<b>ASK</b>		AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
<b>BD</b>		BORDI I DREJTORËVE
<b>BQK</b>		BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
<b>FKGK</b>		FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE
<b>EIB</b>		BANKA EVROPIANE PËR INVESTIME
<b>EIF</b>		FONDI EVROPIAN PËR INVESTIM
<b>GROW</b>		DRITARJA E MUNDËSIVE PËR RIMËKËMBJE TË GJELBËR
<b>IF</b>		INSTITUCIONI FINANCIAR
<b>IFJB</b>		INSTITUCIONET FINANCIARE JOBANKARE
<b>IPF</b>		INSTITUCIONET PARTNERE FINANCIARE
<b>IRF</b>		INSTITUCIONET E REGJISTRUARA FINANCIARE
<b>IFRS</b>		STANDARDI NDËRKOMBËTAR PËR RAPORTIM FINANCIAR
<b>IMF</b>		INSTITUCIONET MIKROFINANCIARE
<b>KFW</b>		BANKA ZHVILLIMORE GJERMANE
<b>KJP</b>		KREDITË JOPERFORMUESE
<b>KMR</b>		KOMITETI PËR MENAXHIM TË RISKUT
<b>KA</b>		KOMITETI I AUDITIMIT
<b>MFPT</b>		MINISTRIA E FINANCAVE PUNËS DHE TRANSFEREVE
<b>MFK</b>		FONDACIONI I MILENIUMIT TË KOSOVËS
<b>MCC</b>		KORPORATA E SIFIDAVE TË MILENIUMIT
<b>MINT</b>		MINISTRIA E INDUSTRIJË NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË
<b>MTI</b>		MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIJË
<b>NMVM</b>		NDËRMARRJE MIKRO, TË VOGLA DHE TË MESME
<b>QRK</b>		QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
<b>PFSF</b>		PROJEKTI PËR FUQIZIMIN E SEKTORIT FINANCIAR
<b>PMMS</b>		POLITIKA E MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
<b>PRE</b>		PAKO E RIMËKËMBJES EKONOMIKE
<b>SIDA</b>		AGJENCIA SUEDEZE PËR ZHVILLIM DHE BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR
<b>SMMS</b>		SISTEMI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
<b>SHBK</b>		SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
<b>USAID</b>		AGJENCIA AMERIKANE PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR

# PËRMBLEDHJE E TREGUESVE OPERACIONALË

TREGUESIT KRYESORË OPERACIONALË	DHJETOR 2021	DHJETOR 2022
<b>KAPITALI</b>	<b>54,917,245</b>	<b>57,735,311</b>
*Potenciali garantues	<b>214,178,534</b>	<b>213,145,173</b>
**Limitet e alokuara	<b>172,750,000</b>	<b>138,241,670</b>
Shkalla e shfrytëzimit të limiteve nga IRF-të partnere	<b>72.2%</b>	<b>84.4%</b>
<b>BILANCI I GARANCIVE</b>	<b>126,092,114</b>	<b>116,269,160</b>
Nr. i kredive aktive të garantuara	<b>6,729</b>	<b>6,916</b>
Nr. i IRF-ve partnere	<b>11</b>	<b>12</b>
Mesatarja e garancive kreditore në gjithsej portofolin e FKGK-së	<b>22,043</b>	<b>22,309</b>
Mesatarja e maturitetit të garancive kreditore në gjithsej portofolin e FKGK-së	<b>37 MUAJ</b>	<b>37 MUAJ</b>
KJP (në %)	<b>1.25%</b>	<b>1.94%</b>
Mbulueshmëria e KJP-së me provizionim (në %)	<b>210.4%</b>	<b>131.2%</b>
<b>KAPITALI I INVESTUAR</b>	<b>51,646,646</b>	<b>60,690,832</b>

Vlerat monetare janë në euro


\* Faktori i Levës në DRITAREN AGRO është zvogëluar nga 3 në 2, në marrëveshje me donatorët.

\*\* Në limitet e alokuara përfshihen ekspozimet në dritaret aktive si dhe dritaret e mbyllura deri më 31.12.2022.

Ulja e limiteve të alokuara është rezultat i përshtatjes së metodologjisë së kalkulimit të limiteve të alokuara kundruall dritareve të mbyllura deri më 31.12.2022.



# PJESA II



# PROFILI I INSTITUCIONIT



## THEMELIMI DHE STATUSI I FKGK-SË

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore është institucion i pavarur, i themeluar me qëllim që të lehtësojë ndërmjetësimin financiar për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM-ve), përmes ofrimit të garancioneve kreditore, deri në 80% të vlerës së kredisë, për institucione financiare të regjistruara.

FKGK-ja është themeluar në janar të vitit 2016, duke u bazuar në Ligjin Nr. 05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore. Ligji mbi themelimin e FKGK-së është sponsorizuar nga MTI-ja, me përkrahje të USAID-it përmes programit "Fuqizimi i mbështetjes kreditore" dhe Bankës Zhvillimore Gjermane (KfW). Ligji për FKGK-në ka hyrë në fuqi më 23 janar 2016, ndërsa aktivitetin operacional institucioni i FKGK-së e ka nisur në muajin shtator të po atij viti.

## MISIONI

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore është entitet juridik i pavarur me karakter zhvillimor, i cili ofron garanci kreditore për NMVM-të, duke ndarë rrezikun kreditor me institucionet e regjistruara financiare. Përmes garantimit të portofolit kreditor të institucioneve financiare, ne synojmë rritjen e qasjes në financa për NMVM-të, mbështetjen e zhvillimit të ndërmarrësisë, mbështetjen e prodhimit vendor dhe të atyre shërbimeve, të cilat krijojnë vlerë të shtuar, krijimin e vendeve të reja të punës dhe mbështetjen e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik.

Ne jemi të përkushtuar ndaj menaxhimit të qëndrueshëm korporativ dhe ndaj përgjegjësisë sociale që vjen me të. Duke koordinuar aktivitetet me partnerët tanë: donatorët, institucionet financiare dhe rregullatorët lokalë, përpiqemi t'u shërbejmë interesave afatgjatë ekonomike të vendit, komunitetit të biznesit dhe shoqërisë sonë në përgjithësi.

# VLERAT INSTITUCIONALE

Vlerat institucionale të FK GK-së, të cilat frymojnë brenda institucionit, si dhe shërbejnë për ndërtimin e praktikave të përditshme në punë, sigurojnë udhërrëfim që aktivitetet tona afariste do të kenë një nivel të lartë të përgjegjshmërisë dhe do të jenë në përputhje me standardet më të larta etike dhe morale.

## TRANSPARENCA

Duke qenë institucion në interes publik, FK GK-ja konsideron si shumë të rëndësishëm shpalosjen e informacionit lidhur me praktikën e punës, politikën dhe rezultatet financiare e operative të institucionit, me partnerët, me palët e tjera të interesit, si dhe me publikun e gjerë.

## PARTNERITETI DHE BASHKËPUNIMI

Ndërtimi i marrëdhënieve të shëndosha, duke u bazuar në transparencë dhe në përgjegjshmëri me partnerët tanë, ndihmon në arritjen e objektivave të përbashkët, në ndërtim të besueshmërisë dhe respekt të ndërsjellë.

## OBJEKTIVITETI DHE PAVARËSIA NË VENDIMMARRJE

FK GK-ja ruan objektivitetin dhe pavarësinë në vendimmarrje, duke u bazuar në ligjin për themelimin e FK GK-së; në parimet e përgjithshme të qeverisjes korporative, si dhe standardeve më të larta etike dhe profesionale.

## PËRKUSHTIMI

Punonjësit e FK GK-së me përkushtim dhe me profesionalizëm mundohen të realizojnë misionin dhe objektivat e saj, duke besuar në rolin dhe në ndikimin pozitiv, që institucioni do ta ketë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

## PUNA EKIPORE DHE PROFESIONALIZIMI NË PUNË

FK GK-ja ka një ekip profesionistësh, të cilët bashkëpunojnë mbi bazat e respektit të ndërsjellë. Puna ekipore për zgjidhjen e problemeve dhe marrjes së iniciativave, komunikimi i hapur dhe ndarja e përvojave profesionale në mes vete, janë bazamenti i suksesit të FK GK-së. Integriteti dhe dinjiteti personal janë vlera që e përcjellin secilin personel në vazhden e realizimit të detyrave dhe të iniciativave në punë, pa bërë asnjë kompromis në respektimin e këtyre parimeve.


## VLERAT MORALE DHE ETIKE

Me qëllim të vendosjes së parimeve dhe të rregullave brenda institucionit, dhe në marrëdhënie me palët e treta, puna e FK GK-së bazohet në Kodin e Qeverisjes Korporative dhe Kodin e Etikes së institucionit.

# AECM - Asociacioni Evropian i Institucioneve Garantuese



AECM është Asociacion Evropian i Institucioneve Garantuese, i cili në vitin 2022 numëroi gjithsej 48 anëtarë që operojnë në 31 vende të ndryshme të Evropës. Që nga viti 2018, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) përfaqëson Kosovën brenda familjes së AECM-së. Anëtarët e AECM-së janë ilustruar në hartën në vijim.



AT	aws NÖBEG	FI	Finnvera	XK	KCGF	RS	GF Vojvodina
AZ	MCGF	FR	Bpifrance EDC SIAGI SOCAMA	LV	ALTUM	SI	SEF SRDF
BE	Brussels GF PMV Standaard- waarborgen WE	DE	VDB	LT	INVEGA	ES	CESGAR
BA	GF Srpska	GR	HDB TMEDE	LU	MC MPME	CH	NSGI
BG	NGF MGFSME	HU	AVHGA Garantiqa	MT	MDB	TR	KGF TESKOMB
HR	HAMAG-BICRO	IE	SBCI	MD	ODA	UK	BBB
CZ	NRB	IT	Garanzia Etica	NL	RVO		
EE	KredEx		ISMEA	PL	BGK		
				PT	BPF		
				RO	FGCR FNGCIMM FRC		



AECM-ja, me bazë në Bruksel, u themelua në vitin 1992 me tri objektiva kyç:

1. Përfaqësim politik i anëtarëve të saj në institucione të BE-së, Grupit EIB, OECD etj.;
2. Organizimi i shkëmbimit të praktikave më të mira ndërmjet anëtarëve të AECM;
3. Promovimi i instrumentit të garancisë.


Anëtarët e AECM-së janë ose skema të garancive të sektorit privat ose institucione publike promovuese ose banka zhvillimore. Misioni i tyre është të mbështesin NMVM-të në qasje më të lehtë në financa, d.m.th. ofrojnë garanci për NMVM-të që posedojnë një projekt ekonomikisht të shëndoshë, por që nuk disponojnë kolateral të mjaftueshëm bankar. I ashtuquajtur i boshllëk i financimit i NMVM-ve që e zgjidhin institucionet garantuese, njihet si dështim i tregut. Duke garantuar për këto ndërmarrje, institucionet e garancisë ndihmojnë në adresimin e këtij dështimi të tregut dhe lehtësojnë qasjen në financa për NMVM-të.

Deri në fund të vitit 2022 anëtarët e AECM-së arritën volum të portofolit garantues në 267 miliardë euro. Numri i NMVM-ve të përkrahura arriti në 5,2 milionë, me volum mesatar të garancisë 45 mijë euro, e ilustruar në vijim.

Gjithsej  
volumi i  
garancive aktive



Numri i  
NMVM-ve të  
përkrahura



Shuma  
mesatare e  
garancive





# PJESA III



# QEVERISJA KORPORATIVE

# BORDI I DREJTORËVE DHE PERSONELI

FKGK-ja qeveriset nga një Bord Drejtorësh në përbërje prej shtatë (7) anëtarësh:

- A. një (1) anëtar sipas detyrës zyrtare, i emëruar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë e Republikës së Kosovës;
- B. një (1) anëtar sipas detyrës zyrtare, i emëruar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Republikës së Kosovës;
- C. katër (4) anëtarë të pavarur, të zgjedhur nga donatorët; dhe
- D. Drejtori Menaxhues i FKGK-së, sipas detyrës zyrtare.

## ANËTARËT E BORDIT TË DREJTORËVE TË FKGK-SË NË VITIN 2022:

### RINOR GJONBALAJ

Kryesues dhe anëtar  
i pavarur i Bordit

\*deri më 3 nëntor 2022



### MELIH CADIRCI

Anëtar i pavarur i Bordit



### ARTA HOXHA

U.D. Kryesuese dhe  
anëtare e pavarur e Bordit

\*nga data 25 nëntor 2022



### SALVADOR ELMAZI

Anëtar i Bordit sipas  
detyrës zyrtare - MFPT



### BESNIK BERISHA

Drejtor menaxhues  
i FKGK-së



### NOL BUZHALA

Anëtar i Bordit sipas  
detyrës zyrtare - MINT

\*deri më 3 nëntor 2022



### KRESHNIK KURTISHI

Anëtar i pavarur  
i Bordit



### ZEF DEDAJ

Anëtar i Bordit sipas  
detyrës zyrtare - MINT

\*nga data 9 dhjetor 2022



# PERSONELI

## Ekipi i FKGK-së në vitin 2022:

**BESNIK BERISHA**  
Drejtor menaxhues

**ALBAN KASTRATI**  
Menaxher i lartë i riskut

**VJOSA BALAJ**  
Menaxhere e lartë e financave dhe e administratës;

**NORA ARIFI**  
Menaxhere e lartë e portofolit

**KASTRIOT KËPUSKA**  
Menaxher i projektit

**BLERT GJINOLLI**  
Specialist mjedisor dhe social

**VILSON UKAJ**  
Specialist i lartë ligjor dhe sekretar i Bordit të Drejtorëve

**JETON REXHEPI**  
Ekspert i riskut kreditor për financim të projekteve  
\*deri më 30 nëntor 2022

**VERË KADRIU**  
Zyrtare për administratë dhe përkthime

**BURBUQE GURI**  
Specialiste e kontrollit

**ANITA TOÇI**  
Specialiste për marketing dhe komunikim

**ALBULENA LUBISHTANI**  
Specialiste për monitorim dhe evaluim  
\*nga data 04.05.2022

**AGNESA BROQI**  
Specialiste për menaxhim financiar  
\*nga data 8 gusht 2022



Numri i personelit të rregullt të FKGK-së është shtatë përderisa pesë janë të angazhuar në implementim të projekteve nga donatoret:

**MENAXHER I PROJEKTIT**  
angazhuar në zhvillimin e Agro Dritares, projekt i mbështetur nga KfW


**EKSPERT I RISKUT KREDITOR PËR FINANCIM TË PROJEKTEVE**  
angazhuar në PFSF me MFK

**SPECIALIST MJEDISOR DHE SOCIAL**  
angazhuar për implementimin e SMMS, angazhuar në kuadër të PFSF me BB

**SPECIALIST PËR MARKETING DHE KOMUNIKIM**  
angazhuar me në kuadër të PFSF me BB

**SPECIALIST PËR MONITORIM DHE EVALUIM**  
angazhuar me ne në kuadër të PFSF me BB.

# STRUKTURA ORGANIZATIVE



# KORNIZA LIGJORE

Në vitin 2022, me rekomandim të FKGK-së dhe propozim të Qeverisë, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore. FKGK-ja, po ashtu me qëllim të përshtatjes me ndryshimin dhe plotësimet e Ligjit për FKGK-në, objektivat strategjike të institucionit dhe marrëveshjet e nënshkruara me palët e treta, modifikoi pjesën më të madhe të legjislacionit sekondar. Si rezultat, Bordi i Drejtorëve miratoi nëntë politika dhe një procedurë. Në kuadër të politikave, ka miratuar ndryshimet dhe plotësimet në politikën për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit me qëllim të harmonizimit me standardet ndërkombëtare dhe kërkesat e institucioneve partnere financiare ndërkombëtare në fushën rregullative të parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit. Po ashtu është miratuar edhe politika e re për mbrojtjen e të dhënave personale në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi dhe Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (GDPR) sipas EU.

Gjatë vitit 2022, FKGK-ja, me qëllim të rritjes së kapitalit për mbështetjen e skemave të garancisë, ka nënshkruar disa marrëveshje me institucionet financiare ndërkombëtare dhe institucionet e regjistruara financiare. Ndër vendimet e rëndësishme të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2022 kanë qenë:

- 1) Miratimi i Marrëveshjes së Ri-garancisë së Portofolit të Kredive me Korporatën Ndërkombëtare Financiare të Zhvillimit të Shteteve të Bashkuara (DFC).
- 2) Miratimi i Dritares GROW, Dritares STANDARDE dhe Dritares së EKSPORTIT.
- 3) Rishikimi dhe miratimi i Dritares AGRO si dhe produktit të LIZINGUT.

# BASHKËPUNËTORËT E FKGGK-SË

Për t'i arritur objektivat dhe synimet FKGGK-ja bashkëpunon me institucionet financiare (bankat, IMF-të, IBJF-të), me donatorët, me Qeverinë e Republikës së Kosovës, me Bankën Qendrore të Kosovës dhe me Komunitetin e NMVM-ve.

## DONATORËT

- Qeveria e Republikës së Kosovës
- Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar
- Banka Zhvillimore Gjermane

## BASHKËPUNËTORËT

- Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar e përfaqësuar nga Ambasada Suedeze
- Banka Botërore
- Fondi Evropian për Investime
- Fondacioni Kosovar i Mileniumit / Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit
- Banka Evropiane për Investime

## INSTITUCIONET E REGJISTRUARA FINANCIARE

### INSTITUCIONET BANKARE

- Banka Ekonomike
- Banka Kombëtare Tregtare
- Banka për Biznes
- NLB Banka
- ProCredit Bank
- Raiffeisen Bank
- TEB

### INSTITUCIONET MIKROFINANCIARE

- AFK
- FINCA
- KEP
- KRK

### INSTITUCIONET FINANCIARE JOBANKARE

- Raiffeisen Leasing Kosovë



# KOMITETET

## KOMITETI I MENAXHIMIT TË RISKUT

Komiteti për Menaxhimin e Riskut është themeluar në bazë të Ligjit për FKGK-në. Komiteti i Menaxhimit të Riskut ndihmon Bordin e Drejtorëve me fokus në fushën e menaxhimit të riskut. Komiteti i Menaxhimit të Riskut mbledhet së paku në baza kuartale dhe përbëhet nga tre (3) anëtarë të Bordit, përderisa menaxheri i lartë i riskut është pjesëmarrës i përhershëm i Komitetit.

Si i tillë, Komiteti shqyrton politikat e riskut kreditor dhe operativ, mbikëqyr zhvillimet e portofolit të garantuar dhe siguron që profili i riskut kreditor është në përputhshmëri me politikat kreditore, me ligjet dhe me rregulloret e zbatueshme.

## KOMITETI I AUDITIMIT

Komiteti i Auditimit është i themeluar në bazë të Ligjit për FKGK-në. Komiteti i Auditimit përbëhet nga katër (4) anëtarë të Bordit dhe takimet mbahen në baza tremujore.

Ky komiteti është përgjegjës për dhënien e rekomandimeve Bordit të Drejtorëve për çështjet e menaxhimit të rrezikut, të kontrollit të brendshëm, pasqyrave financiare, kërkesave të pajtueshmërisë, auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, po ashtu funksioneve të tjera relevante të qeverisjes së FKGK-së. Përveç kësaj, Komiteti i Auditimit rishikon kontrollet e brendshme financiare, operative dhe administrative.



# MBLEDHJET E BORDIT TË DREJTORËVE DHE KOMITETEVE PËRKATËSE

## MBLEDHJET E BORDIT TË DREJTORËVE TË FKGK-SË

Gjatë vitit 2022 Bordi i Drejtorëve i FKGK-së mbajti gjithsej pesë (5) mbledhje të rregullta. Në mbledhjet e bordit janë marrë disa vendime të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të FKGK-së, dhe marrëdhëniet e FKGK-së me palët e treta.

*Tabela në vijim paraqet mbledhjet e Bordit dhe të komiteteve ndihmëse të Bordit të Drejtorëve të FKGK-së:*

Orari i mbledhjeve të Bordit	Pjesëmarrja e anëtarëve të Bordit	Numri i temave të diskutuara	Numri i vendimeve të marra
25 Shkurt 2022	7/7	16	8
22 Prill 2022	7/7	12	6
17 Qershor 2022	7/7	13	9
23 Shtator 2022	7/7	26	22
25 Nëntor 2022	6/7	13	7
<b>Gjithsej:</b>		<b>80</b>	<b>52</b>

## MBLEDHJET E KOMITETIT PËR MENAXHIM TË RISKUT DHE TË KOMITETIT TË AUDITIMIT

Gjatë vitit 2022 Komiteti për Menaxhim të Riskut (KMR) mbajti pesë (5) mbledhje të rregullta. Po aq mbledhje të rregullta mbajti edhe Komiteti i Auditimit (KA). Në këto takime komitetet përkatëse nxorën vendime dhe rekomandime për menaxhmentin e FKGK-së dhe për miratimin përfundimtar nga Bordi i Drejtorëve i FKGK-së.

*Tabela në vijim paraqet mbledhjet e komitetit të menaxhimi të riskut:*

Orari i mbledhjeve të KMR-së	Pjesëmarrja e anëtarëve të KMR-së	Numri i temave të diskutuara	Numri i vendimeve/ i rekomandimeve të marra
09 Shkurt 2022	3/3	5	1
06 Prill 2022	3/3	8	3
08 Qershor 2022	3/3	4	1
07 Shtator 2022	3/3	10	3
09 Nëntor 2022	2/3	6	3
<b>Gjithsej:</b>		<b>35</b>	<b>18</b>

*Tabela në vijim paraqet mbledhjet e komitetit të auditimit:*

Orari i mbledhjeve të KA-së	Pjesëmarrja e anëtarëve të KA-së	Numri i temave të diskutuara	Numri i vendimeve/ i rekomandimeve të marra
11 Shkurt 2022	4/4	7	0
13 Prill 2022	4/4	6	1
10 Qershor 2022	4/4	6	0
12 Shtator 2022	4/4	6	0
18 Nëntor 2022	4/4	6	0
<b>Gjithsej:</b>		<b>27</b>	<b>1</b>



# PJESA IV



# PERFORMANCA E FKGGK-së

# ZHVILLIMI I PORTOFOLIT TË GARANCIVE

Gjatë vitit 2022, FKGK vazhdoi të ofrojë garanci kreditore për NMVM-të, duke ndarë rrezikun kreditor me institucionet financiare nëpërmjet dritareve të përshtatura karakteristikave dhe nevojave të NMVM-ve përkatëse. Vetëm gjatë këtij viti në sajë të ndërmjetësimit të FKGK-së u mundësua kredidhënia në sektor me vlerë prej 97.5 milionë euro shpërndarë në 2,021 kredi për 1,750 NMVM.

Shuma kumulative e kredive të miratuara në fund të vitit arriti vlerën prej 506.3 milionë eurosh për 8,871 NMVM, e mbështetur nga një shumë kumulative e garancive prej 269.58 milionë euro. Vlera totale e mbetur e portofolit të kredive, në fund të vitit 2023, ishte 211.46 milionë euro, përderisa vlera totale e mbetur e portofolit të garantuar ishte 116.69 milionë euro shpërndarë në 6,865 kredi aktive.


Portofoli i garantuar edhe gjatë 2022, vazhdon të ketë pjesëmarrje më të madhe nga ndërmarrjet mikro. Përqendrimi i portofolit të garantuar sipas

numrit të punëtorëve në segmentin e ndërmarrjeve mikro dhe të vogla deri në 49 punëtorë ishte 99%.

Stimulimi i sektorëve që krijojnë vlerë të shtuar për ekonominë si dhe diversifikimi sa më i mirë mbetën një nga objektivat e FKGK-së. Prandaj, FKGK me ndihmën e donatorëve dhe partnerëve të saj ka punuar në vazhdimësi në ndërtimin e produkteve të cilët do të mbështesin fuqizimin e sektorëve strategjik.


Sektori më dominues në portofolin e kredive të garantuara gjatë vitit 2022 ishte ai i tregtisë me pakicë dhe me shumicë me 41%, i vijuar nga shërbimet me 24%, prodhimi me 20%, ndërtimtaria me 10% dhe bujqësia me 5%\*. Në krahasim me një vit më parë, lëvizja nëpër sektor vërehet sidomos në sektorin e shërbimeve në të cilin kishim një rritje prej 9% (24% nga 22% sa ishte një vit më parë).

\* Bazuar në klasifikimin e sektorëve sipas NACE kodeve.



# ZHVILLIMI I PORTOFOLIT TË GARANCIVE PËR VITIN 2022

Vazhdimësi e rritjes së shpejtë  
dhe me cilësi të lartë



Rreth 99% e portofolit përbëhet nga  
ndërmarrjet mikro dhe të vogla



në kapital  
punues

NMVM-të  
shfrytëzuan  
kreditë për  
investime:



në pajisje dhe tokë,  
ndërtim ose në rinovim

# DRITARJA AGRO - ZHVILLIMI/RISITË


FKGK-ja vazhdon ta konsiderojë financimin dhe garantimin e agro sektorit si një mundësi e mirë e krijimit të vendeve të reja të punës, zhvillimit ekonomik dhe zëvendësimit të produkteve ushqimore të importuara. Deri në fund të vitit 2022, FKGK-ja ka nënshkruar marrëveshje për Dritaren Agro me 11 Institucione të Regjistruara Financiare (IRF), respektivisht me 7 banka dhe 4 Institucione Mikrofinanciare (IMF) që janë aktive në agro kredi dhënie.

Në muajin gusht të vitit të kaluar janë miratuar disa ndryshime të propozuara në Ligjin mbi Themelimin e FKGK-së (LTHFKGK), të cilat ndryshime kanë mundësuar, ndër të tjera, edhe garantimin e vazhdueshëm të fermerëve që posedojnë Certifikatë të Fermerit dhe Numër Identifikues të Fermës (NIF). Si rrjedhojë e ndryshimeve në këtë ligj, fermerëve dhe agrobizneseve vendore do t'u mundësohet garantimi deri në 60% të kredisë së tyre bujqësore. Gjatë vitit 2022 janë miratuar gjithsej 8,8 mil. € kredi të reja nga bankat dhe IMF që janë aktive në sektorin

e bujqësisë të cilat janë vënë nën garancionin e FKGK-së dhe janë gjithsej 212 kredi të garantuara në Dritaren Agro. Shuma mesatare e kredive të garantuara në sektorin e bujqësisë gjatë 2022-tës ishte rreth 41.5K € me maturitet mesatar mbi 38 muaj. Sipas deklarimit nga ana e bankave, gjatë vitit 2022 janë garantuar nga ana e FKGK-së rreth 29.6% e volumit dhe 31.1% e numrit të agro kredive që janë dhënë tek bizneset e regjistruara në ARBK dhe që janë financuar nga ana e tyre.

Deri në fund të vitit 2022, vetëm në Dritaren Agro, në total janë garantuar rreth 34.1 mil. € dhe 954 agro kredi, përderisa nëse shtohet garantimi i agro sektorit edhe gjatë Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike, ky volum shkon në mbi 41.1 mil. € tek 1,104 kredi në total.


Shpërndarja rajonale e këtyre kredive të lëshuara nga IFP-të dhe të garantuara nga FKGK-ja, në rajone të ndryshme për sektorin e bujqësisë gjatë vitit 2022 është si në vijim:



Gjatë vitit 2022, nga 212 agro kredi të garantuara nga ana e FKGK-së në Dritaren Agro, IRF-të parashihnin mbi 6.4 mil. € rritje të qarkullimit të klientëve të tyre nga investimet e bëra, si dhe 383 vende të reja pune të deklaruar mbi bazën e tanishme.

# TË ARRITURAT E DRITARES AGRO

## DERI MË 31 DHJETOR 2022



Me ndryshimet në Ligjin për FKGK-në, lejohet edhe garantimi i fermerëve që posedojnë Certifikatë të Fermerit dhe Numër Identifikues të Fermës (NIF)

\*PËR PERIUDHËN  
JANAR-DHJETOR 2022 DHE  
BIZNESET E REGJISTRUARA NË ARBK

# SHTUESHMËRIA

Shtueshmëria është arsyeja thelbësore e themelimit të FKGK-së. FKGK ka për qëllim të krijojë biznese të reja, të zgjerojë bizneset ekzistuese, të krijojë mundësi të reja për punësim, si dhe të krijojë mundësi për inovacion teknologjik. FKGK-ja u mundëson NMVM-ve të kenë qasje në kredi të cilat mund të mos kenë qenë në gjendje të marrin kredi në mungesë të këtij institucioni. Kjo shtueshmëri e FKGK-së kontribuon në rritjen e përgjithshme të mirëqenies ekonomike, duke u bërë një mjet vendimtar për zhvillimin e NVM-ve dhe promovimin e ndërmarrësisë në vend.


Për ta vërejtur ndikimin e FKGK-së janë analizuar indikatorët e ndërlidhur me shtueshmërinë financiare duke reflektuar në të dhënat e siguruara nga Regjistri Kreditor i Kosovës dhe të dhënat e siguruara nga MIS i brendshëm i FKGK-së.

Rezultatet e monitorimit të këtyre indikatorëve paraqesin pjesëmarrjen e FKGK-së në sektorin bankar si dhe ndikimin e skemës garantuese në mesataren e vlerës së kredive të garantuara nga FKGK-ja në krahasim me ato të sektorit, zgjatjen e maturitetit, uljen e kërkesës për kolateral etj.




## PJESËMARRJA E KREDIVE TË GARANTUARA NË SEKTORIN BANKAR

Nga grafiku në vijim vërehet që pjesëmarrja e kredive të garantuara në sektorin bankar është më e theksuar tek bizneset që për herë të parë kanë marrë kredi. Pjesëmarrja në kategorinë e kredive të reja me vlerë 50,000 deri në 100,000 euro ishte 32%, ndërsa pjesëmarrja e të gjitha kredive në këtë kategori ishte 22%. Për vlerat më të mëdha të kredive, pjesëmarrja e kredive të garantuara nga FKGK është më e vogël duke arritur në vlerën më të vogël prej 2% për kreditë deri 1 milion euro. Ky është një rezultat i pritshëm për shkak se qëllimi i FKGKsë është të shtojë vlerë në sektorin bankar duke e rritur numrin e klientëve që asnjëherë nuk kanë marrë kredi dhe poashtu duke rritur pjesëmarrjen në kreditë me vlerë deri në 100,000 euro.




Në mesatare, kreditë e reja të garantuara nga FKGK kanë vlerë më të lartë në krahasim me ato të pagarantuara. Kjo edhe njëherë tregon ndikimin e skemës garantuese duke pas parasysh që kjo skemë ofron një siguri ndaj bankës në rast dështimi të kredisë.




## MESATARJA E MATURITETIT TË KREDISË - KOHËZGJATJE MË E LARTË E KREDIVE

Maturiteti i kredive të garantuara vazhdon të jetë më i lartë sesa i atyre të pagarantuara. Grafiku më poshtë paraqet mesataren e maturitetit për vlerat e ndryshme të kredive. Gjatë vitit 2022, në mesatare kreditë e garantuara kishin maturitet prej më shumë se 41 muajsh ndërsa ato të pagarantuara kishin maturitet mesatarisht prej 33 muajsh. Ky rezultat paraqet kushtet më të favorshme të financimit të kredive të garantuara në krahasim me ato të pagarantuara.



## MBULUESHMËRIA ME KOLATERAL

Ndikimi i skemës garantuese vërehet edhe në kërkesën për kolateral. Në krahasim me ato të pagarantuara, kredive të garantuara, mesatarisht u kërkohe afër 70% më pak kolateral. Tek kreditë e reja të garantuara, diferenca në kërkesën për kolateral vërehet më shumë; kredive të reja të garantuara, mesatarisht u kërkohe 92% më pak kolateral në krahasim me kreditë e reja të pagarantuara.



## PJESËMARRJA E VOLUMIT TË KREDIVE AKTIVE TË GARANTUARA NGA FKGK NË BRUTO PRODHIMIN VENDOR (BPV)

Skema garantuese është një ndër politikat më kryesore, nëse jo më kryesorja, për të mbështetur NVM-të në periudha të hendeikut të likuiditetit. Pjesëmarrja e volumit të kredive aktive të garantuara nga FKGK-ja në Bruto Produktin e Vendit (BPV) për vitin 2022 është 1.28%. Kjo është më e ulët se ajo e vitit 2021 (1.6%), por më e lartë se ajo e vitit 2020 (0.8%). Pjesëmarrja më e lartë gjatë vitit 2021 është për shkak të politikave mbështetëse për të ndihmuar në përmirësimin e situatës ekonomike dhe në shmangien e dëmeve më të mëdha në tregun e punës pas periudhës së Covid-19, dhe si e tillë, nuk duhet të krahasohet me vitet e tjera.

## PJESËMARRJA E BIZNESEVE TË GARANTUARA NË RAPORT ME TË GJITHA BIZNESET AKTIVE NË EKONOMINË REALE

Në bazë të OECD (2022), në vitin 2022 kishte rreth 43,000 biznese aktive në Kosovë. Nga ky numër, rreth 8,800 NVM kanë përfitur nga skema garantuese e FKGK-së apo 16.7% të sektorit të përgjithshëm të NMVM-ve në fund të vitit ( sipas AECM) . Kjo pjesëmarrje është në rritje nëse e krahasojmë me vitin e mëparshëm (11%) duke treguar rëndësinë e FKGK-së në rritjen e përgjithshme të NMVM-ve.

# MENAXHIMI I RISKUT KREDITOR

Shërbimi që ofrohet nga FKGK-ja, që është garantimi i pjesshëm i kredive të NMVM-ve të lëshuara nga Institucionet e Regjistruara Financiare (IRF), paraqet burimin kryesor të rrezikut me të cilin përballet FKGK-ja. Meqenëse vlerësimi i riskut kreditor, vendimmarrja si dhe mirëmbajtja e NMVM-ve që kanë kredi të garantuar nga FKGK-ja i është besuar IRF-ve, mekanizmat e FKGK-së për menaxhimin e riskut në nivel individual janë të kufizuara. Duke qenë të vetëdijshëm për rreziqet që burojnë nga një aktiviteti i tillë, proceset dhe korniza e menaxhimit të rrezikut në FKGK i është përshtatur një qasjeje pro-aktive të menaxhimit të riskut në nivel të portofolit.

Më konkretisht, proceset në FKGK janë disenjuar në atë mënyrë që do të sigurojnë menaxhimin e duhur të riskut të garancisë përmes përcaktimit të ekspozimit agregat të garancisë sipas faktorit të levës, përcaktimit të tolerancës së riskut në shumicën e produkteve garantuese apo në nivel të IRF-ve, përcaktimit të kushteve dhe kriteve të qarta kualifikuese për IRF, pastaj për NMVM, për kreditë apo planet investuese që kualifikohen. Theks të veçantë në menaxhim të riskut në FKGK ka mbikëqyrja dhe kontrolli i vazhdueshëm, andaj në baza të rregullta FKGK-ja zhvillon monitorimin dhe kontrollon në nivel të sektorit financiar, IRF-ve si dhe kredimarrësve të garantuar.

Për të nxitur bashkëpunimin në baza të shëndosha, në dritaret garantuese të përgjithshme, ndarja e rrezikut me IRF-të bëhet në baza të barabarta, respektivisht deri në 50%, përderisa te dritaret që kanë për qëllim adresimin e nevojave të segmenteve të caktuara të tregut, mbulueshmëria me garancion ofrohet në përqindje më të lartë. Po ashtu, FKGK-ja synon ndarjen sa më të madhe të rrezikut me skema rigarantuese, të cilat mundësojnë mitigim sa më të mirë të riskut të FKGK-së.

Diversifikimi konsiderohet si mjet për mitigim të riskut të portofolit, andaj FKGK-ja ka ndërtuar procese që mundësojnë diversifikim të kënaqshëm, i cili synohet te paktën në këto nivele:

- Në nivel të IRF-ve, përmes ndarjes së limiteve garantuese, dhe përmes përcaktimit të ekspozimit maksimal garantues për një IFR;
- Në nivel të NMVM-ve, përmes përcaktimit të ekspozimit maksimal garantues për një NMVM me gjithë palët e ndërlidhura. Sipas të dhënave të fund vitit, ekspozimi më i lartë garantues ishte 0.9% në raport me kapitalin e FKGK-së, përderisa 10 ekspozimet më të larta në raport

me kapitalin janë rreth 6%;

- Në nivel sektorial FKGK-ja përkujdeset që të mos ketë përqendrim të lartë në një sektor, respektivisht ekspozimi i sektorit të jetë në përputhje me objektivat e FKGK-së dhe rrethanat në treg. Sipas të dhënave të fundvitit, sektori me pjesëmarrjen më të lartë në portofolin e garantuar e kishte tregtia me 41%, e ndjekur nga sektori i shërbimeve dhe të prodhimtarisë.
- Në nivel regjional, FKGK-ja po ashtu monitoron zhvillimin e portofolios dhe synon që zhvillimi rajonal të jetë në përputhje me rrethanat në treg apo me objektivat e FKGK-së.
- Nëse FKGK-ja vlerëson që ka koncentrim të lartë në ndonjëherën nga fushat e lartcaktuara që rrezikon portofolin e FKGK-së apo nuk është në përputhje me qëllimet, atëherë FKGK-ja mund të marrë masa për të reduktuar rrezikun e koncentrimin, përmes përcaktimit të kufizimeve të caktuara në limitet e reja garantuese të IFR-të përkatëse.

Nëse FKGK-ja vlerëson që ka koncentrim të lartë në ndonjëherën nga fushat e lartcaktuara që rrezikon portofolin e FKGK-së apo nuk është në përputhje me qëllimet, atëherë FKGK-ja mund të marrë masa për të reduktuar rrezikun e koncentrimin, përmes përcaktimit të kufizimeve të caktuara në limitet e reja garantuese të IFR-të përkatëse.

## MENAXHIMI I RISKUT TË LIKUIDITETIT

Garancioni kreditor paraqet riskun kryesor për FKGK-në, rrjedhimisht FKGK-ja ekspozohet edhe ndaj rrezikut të likuiditetit, respektivisht rrezikut të pamundësisë t'i përmbushë detyrimet. Menaxhimi efektiv i riskut të likuiditetit është thelbësor për të ruajtur besimin e donatorëve dhe institucioneve financiare partnere, si dhe për të mundësuar që veprimtaria bazë të vazhdojë. FKGK-ja ka kapital të mjaftueshëm për të mbuluar obligimet dhe kjo bën që të jetë një institucion stabil dhe të ofrojë siguri në tregun financiar. FKGK-ja investon kapitalin pjesërisht në depozita me afat të institucionet financiare partnere dhe pjesërisht në Letra me Vlerë të Republikës së Kosovës, me qëllim të gjenerimit të të hyrave nga interesi dhe mbulimin e shpenzimeve operacionale. Politika e investimeve adreson mënyrën e investimeve të kapitalit të FKGK-së duke përfshirë planifikimin e duhur të likuiditetit në mënyrë që FKGK-ja të ketë gjithmonë fonde të mjaftueshme të nevojshme për shlyerjen në kohë të detyrimeve. FKGK-ja investon mjetet duke u bazuar në parimet e ndarjes proporcionale sipas politikës së investimeve. FKGK-ja investon deri në 70% të totalit

të investimeve te institucionet partnere financiare, ndërsa pjesa tjetër, pra 30%, investohet në Letra me Vlerë të Qeverisë së Kosovës. Përveç ndarjes së investimeve sipas institucioneve financiare partnerë, ka edhe një aspekt tjetër të ndarjes së investimeve, dhe kjo është sipas maturitetit të tyre. Rreth 60% e investimeve kanë një maturitet deri në njëzet e katër muaj, ndërsa 40% e tyre kanë një maturitet prej mbi njëzet e katër muaj deri në gjashtëdhjetë muaj. Për investimet me maturitet deri në njëzet e katër muaj, të paktën 30% duhet të kenë maturitet deri në dymbëdhjetë muaj. Ndërsa për investimet me maturitet mbi njëzet e katër muaj deri në gjashtëdhjetë muaj, të paktën 20% duhet të kenë maturitet nga tridhjetë e gjashtë muaj deri në dyzet e tetë muaj. Në këtë mënyrë, FKGK-ja kujdeset të kontrollojë rrezikun e likuiditetit duke përcaktuar limitet e pjesëmarrjes sipas maturitetit të investimeve. FKGK-ja mban mjete të lira në llogarinë e BQK-së për qëllime të likuiditetit, dhe po ashtu, investimet në depozita me afat ndjekin një maturim të njëpasnjëshëm përgjatë muajve të vitit, ku në secilin muaj lirohen mjete nga depozitat që maturojnë. Në këtë mënyrë, FKGK-ja menaxhon investimet, i riafaton apo mund t'i tërheqë mjetet e lira në rast të nevojës për likuiditet dhe në këtë proces nuk shprehet nevoja të ndërpriten afatizimet e tjera, duke mirëmbajtur likuiditetin dhe optimizuar të hyrat.

## PARANDALIMI I PASTRIMIT TË PARAVE DHE LUFTIMI I FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

Në pajtim me Politikën të FKGK-së për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit (Politika për PPP/LFT), FKGK-ja në kuadër të MIS ka aplikuar sistemin e raportimit të kredive të kualifikuara në nivel të riskut të ulët, të mesëm dhe të lartë dhe raportimin e tyre në aspekt të personave të ekspozuar politikisht. IRF-të për çdo kredi për pranim nën garanci raportojnë edhe nivelin e kategorizimit të PPP/LFT-së dhe të personave të ekspozuar politikisht. FKGK-ja në bazë të rregullt monitoron kreditë dhe kredimarrësit e kualifikuar në aspekt të pajtueshmërisë me kërkesat në fushën e PPP/LFT-së.

FKGK-ja, sipas kërkesave të Politikës për PPP/LFT dhe në kuadër të marrëveshjes me BEI-në dhe DFC-në ka zhvilluar procesin njohjes së klientit tuaj (KYC) me institucionet e regjistruara financiare bankare me qëllim të kualifikimit të tyre për përfitim nga skemat e garantuese dhe rigarantuese.

FKGK-ja po ashtu ka bërë vlerësimin vjetor të bankave të regjistruara në aspekt të përmbushjes së kriterëve dhe të kushteve ligjore dhe standardeve në aspekt të:

- Miratimit të politikave, të procedurave dhe të praktikave në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit;
- Mirëmbajtjes së listës së sanksioneve për bizneset dhe individët dhe transaksionet e tyre dhe azhurimit të tyre në pajtueshmëri me listat e sanksioneve e institucioneve respektive ndërkombëtare;
- Bashkëpunimin me institucionet vendore kompetente;
- Organizimin e trajnimeve dhe vetëdijesimin për stafin e IRF-ve në fushën e PPP/LFT;
- Kryerjen e auditimeve të posaçme dhe implementimin e rekomandimeve të dhëna;
- Kujdesin e rregullt të realizimit të procesit të KYC me klientët e tyre që njëkohësisht janë edhe kredimarrës të kualifikuar nga FKGK-ja.

## AKTIVITETET PËR MENAXHIMIN E RISKUT GJATË VITIT 2022

FKGK-ja përpiket të mbajë një qasje pro-aktive për menaxhimin e rrezikut, andaj edhe gjatë vitit 2022 politikat dhe procedurat e rrezikut janë përditësuar me qëllim të menaxhimit sa më të mirë të riskut. Ndryshimet në politikën e riskut kishin për synim pasurimin e produkteve përmes ndryshimeve të kriterëve kualifikuese që synojnë përfshirje sa më të madhe të NMVM, përkrahje të shtuar në sektorë të cilët konsiderohen më pak të shërbyer apo që kanë rëndësi të veçantë për zhvillim ekonomik të vendit si dhe vendosjen e masave të tjera për mitigim dhe zbutje të rrezikut.

Në përputhje me politikat dhe proceset e brendshme, FKGK-ja ka shqyrtuar dhe ka miratuar kërkesat për rivlerësimin e limiteve të pothuajse gjithë IRF-ve gjatë vitit 2022; ka shqyrtuar dhe ka modifikuar politikat e brendshme në përputhje me modifikimet e bëra në dritaret përkatëse; ka menaxhuar në mënyrë efektive rrezikun e perceptuar nga inflacioni. Përveç kësaj, gjatë vitit të kaluar FKGK-ja vazhdoi praktikën e mbledhjeve të rregullta mujore, ku analizohen trendët në sektorin bankar në përgjithësi dhe në veçanti për secilën IPF, si dhe analizohet zhvillimi i portofolit të garantuar.

Brenda kapaciteteve ekzistuese FKGK-ja vazhdoi rritjen e limiteve garantuese ndaj IRF, përmes rritjes së limiteve në dritaret ekzistuese apo përmes alokimit të limiteve të reja në dritaret e reja. Gjithsej ekspozimi i FKGK-së ndaj IRF-së ishte 138.2 mil euro, që përfshin ekspozimin në dritaret e mbyllura si dhe limitet garantuese në dritaret aktive. Ekspozimi i FKGK-së ndaj IRF-ve është i mbuluar me kapital, i cili sipas të dhënave të fundvitit ishte 57.7 mil euro, i përbërë nga fondet e dhuruara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, donatorët ndërkombëtarë

si dhe fitimi i mbajtur. Duhet theksuar që fondet janë dhuruar për qëllime specifike dhe kanë kritere të veçanta, të cilat edhe pse kufizojnë efikasitetin e shfrytëzimit të kapitalit, krijojnë besueshmëri që FKGG-ja është mjaftueshëm e kapitalizuar dhe ka aftësi të absorbojë riskun ndaj të cilët është i ekspozuar. Gjatë vitit 2022, FKGG-ja filloi të shfrytëzojë skemën rigarantuese të DFC (U.S. International Development Finance Corporation) që ofron mundësinë e ndarjes së rrezikut përmes mbulimit me 50% të kredive të garantuara në dritaren GROW. Kjo skemë rigarantuese, së bashku me rigarantimin nga SIDA dhe programin COSME të EIF-së i kanë mundësuar FKGG-së ndarjen e pjesëshme të riskut kreditor, rritjen e kapacitetit garantues, uljen e shpenzimeve të provizionit, si dhe zvogëlimin e tarifave për kreditë që garantohen.

### NDIKIMI I FAKTORËVE TË JASHTËM NË PËRFORMANCËN E FKGG-SË

Përkundër përmirësimit të situatës ekonomike pas pandemisë, klima ekonomike në vendin tonë u ndikua nga kriza energjetike si dhe inflacionin në nivel global. Pasiguria e paraqitur zbehu perspektivën ekonomike në Kosovë dhe krijoi sfida

të reja të sektori financiar në Kosovë, ku FKGG-ja nuk mund të trajtohet e izoluar nga këto ndikime. Por, përkundër sfidave të lartpërmendura, sektori financiar në Kosovë edhe gjatë vitit 2022 vazhdoi të mbetet likuid dhe i shëndoshë, që u reflektua edhe në rezultatet e performancës së FKGG-së.

Në rrethanat e krijuara, përkundër rrezikut të shtuar, FKGG-ja ishte e përcaktuar që të ndihmohet në vazhdimin dhe nxitjen e kreditimit nga IRF-të përmes krijimit të dritareve (produkteve) specifike të përshtatura për projekte që synojnë nxitjen e investimeve në prodhimin e energjisë së ripërtërishtme apo investime që rrisin efikasitetin e energjisë, në projekte zhvillimore që synojnë përkrahjen e ndërmarrjeve eksportuese, apo zhvillimit të bujqësisë, por duke mos i lënë anash edhe NMVM-të në aktivitete të tjera. Masa të tjera të menaxhimit të riskut janë pagesat e kërkesave të paraqitura nga IRF-të, si dhe zgjatja e afatit të kredive përmes rristurimeve të kredive që janë garantuar. Këto masa të ndërmarra nga FKGG-ja mund të konsiderohen si instrumente të mira që kanë ndikuar në zbutjen e efekteve të inflacionit dhe zhvillimin e NMVM-ve.




# KUALITETI I PORTOFOLIT

Në vitin 2022, kualiteti i kredive të garantuara ka vijuar të jetë në nivel të parashikuar. Bilanci garantues sipas të dhënave më 31 dhjetor 2022 ishte në vlerë prej 116.7 mil euro, përdherisa kualiteti i portofolit, matur me kreditë delikvente dhe

joperformuese shënoi një rritje të vogël gjatë vitit 2022, por ajo ngritje ishte në nivelin e parashikuar dhe reflekton gjendjen e kualitetit të portofolit për kreditë e NMVM-ve në treg. Sipas të dhënave të fundvitit, delikuenca e kredive të garantuara ishte 1.10%, niveli i kredive joperformuese (KJP) ishte 1.94%, përdherisa niveli i kërkesave të paguara (përfshirë vitet paraprake) arriti vlerën 1,1 mil euro, që në raport me bilancin e garantuar është 0.94%.


## KUALITETI I PORTFOLIT NË NIVEL TË FKGK-SË



Në vitin 2022 numri i kërkesave për pagesë ka dëshmuar ngritje në raport me vitet paraprake. Gjithë kërkesat e paraqitura nga IPF-ja për kreditë e kualifikuara janë vlerësuar në përputhje me marrëveshjen e garancisë dhe politikat interne të FKGK-së. Gjatë vitit 2022 FKGK-ja ka paguar gjithsej 44 kërkesat për kreditë të garantuara në


vlerë prej 572K eurosh, që në nivel vjetor paraqet 0.47%, në raport me bilancin e garantuar. Maturiteti mesatar i kredive të garantuara nga FKGK-ja është rreth 3 vjet, që reflektohet edhe në amortizimin e portofolit të FKGK-së. Siç shihet në tabelën në vijim pjesa më e madhe e portofolit të FKGK-së përbëhet nga kreditë e lëshuara nga viti 2020 e tutje.

## AMORTIZIMI I PORTFOLIT - NDARË NË VITE



Gjatë vitit 2022 kujdes të veçantë i është kushtuar monitorimit të portofolit sipas dritareve, në veçanti dritareve të krijuara gjatë pakos së rimëkëmbjes ekonomike, për shkak të mbulueshmërisë më të lartë si dhe NMVM e garantuar ishin kryesisht

nga sektorët e prekur gjatë pandemisë. Në bazë të analizës krahasuese për të njëjtën periudhë, performanca e dritareve brenda pakos së rimëkëmbjes ekonomike ishte më e ulët se dritaret tjera.



## REZERVAT E PROVIZIONIMIT

FKGK-ja vijoi ndërtimin e rezervave të provizionimit sipas standardet të IFRS9, respektivisht sipas modelit të humbjeve të pritura. Rezerva për humbjet e pritura për kreditë e garantuara si dhe asetet tjera arrijnë në 3.23 mil euro, përderisa në vitin paraprak ato ishin 3.57 mil euro, që është 9% më e lart se

në vitin paraprak. Rezervat totale të provizionimit të garancive në vitin 2022 ishin 2.6% në raport me bilancin e garantuar që është e përafërt me sektorin financiar në Kosovë, përderisa mbulueshmëria e kredive jo-përformuese është 131.2% që dëshmon mbulueshmëri të mjaftueshme me rezerva.

### Rezervat e provizionimit për portfolion e garantuar

Garancionet	Bil. Garantues	Provizionimi	Provizionimi %	PAR
Faza 1	112,469,254	1,326,585	1.2%	96.4%
Faza 2	1,920,683	479,651	25.0%	1.6%
Faza 3	2,303,222	1,214,963	52.8%	2.0%
<b>Totali</b>	<b>116,693,160</b>	<b>3,021,200</b>	<b>2.6%</b>	<b>100.0%</b>

Krahas garancioneve, FKGK ndërtoi rezerva të provizionimit edhe për asete tjera, që përfshijnë depozitat të IRF-të si dhe në bono qeveritare të Republikës së Kosovës.

### Rezervat e provizionimit për asetet tjera

Asetet Tjera	Investimet	Provizionimi	Provizionimi %
Faza 1	62,686,670	211,678	0.3%
<b>Totali</b>	<b>62,686,670</b>	<b>211,678</b>	<b>0.3%</b>

Vlen të potencohet që modeli i humbjeve të pritura, shërben si informacion shumë i mirë në lidhje me perspektivën e cilësisë së portofolit të FKGK-së, e cila përdoret edhe në modelin e kalkulimit të tarifës së garantuar.

# STRUKTURA E KAPITALIT

Kapitali i FKGK-së përbëhet nga fondet e dhuruara nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe nga donatorët ndërkombëtarë. Në tabelën në vijim, prezantohet në detaje kapitali i FKGK-së nga viti 2016 deri në fund të vitit 2022. Qeveria e Republikës

së Kosovës ka kontribuar me 42% të kapitalit, njëjtë sikurse dhe KfW. USAID-i ka participuar me 10%, si dhe fitimi i akumuluar participon me 6%. Në vitin 2022 nuk ka pasur kontribut shtesë në kapital, mirëpo janë regjistruar 2,818,066 milionë euro si fitim i akumuluar. FKGK-ja nuk shpërndan dividendë, dhe çdo fitim rikapitalizohet për të rritur kapitalin dhe rrjedhimisht potencialin garantues.

	Qeveria e Republikës së Kosovës	USAID	KfW	Fitimi i akumuluar	Gjithsej
<b>Kapitali 2016</b>	2,000,000 €	5,345,141 €	-	3,149 €	7,341,992 €
<b>Kapitali 2017</b>	1,000,000 €	445,780 €	7,000,000 €	179,017 €	8,624,797 €
<b>Kapitali 2018</b>	-	-	-	320,012 €	320,012 €
<b>Kapitali 2019</b>	-	-	-	484,334 €	484,334 €
<b>Kapitali 2020</b>	21,410,000 €	-	11,500,000 €	66,312 €	32,976,312 €
<b>Kapitali 2021</b>	-	-	5,600,000 €	430,202 €	5,169,798 €
<b>Kapitali 2022</b>	-	-	-	2,818,066 €	2,818,066 €
<b>Gjithsej</b>	24,410,000 €	5,790,921 €	24,100,000 €	3,434,390 €	57,735,311 €
<b>%</b>	42%	10%	42%	6%	100%


Kapitalizimi i institucionit është i një rëndësie të veçantë për të mundësuar rritjen e potencialit garantues të FKGK-së dhe njëkohësisht për të transmetuar siguri në tregun financiar. FKGK-ja përdor një politikë të leverimit të kapitalit të saj që përcaktohet varësisht nga indikacionet e riskut në treg/sector, duke u siguruar që FKGK-ja të ketë kapital të mjaftueshëm për ta kryer aktivitetin e saj dhe për t'i

absorbuar humbjet e mundshme. Rritja e potencialit garantues ndikon në rritjen e kreditimit nga ana e institucioneve financiare duke u ofruar komfort për të hulumtuar treg të ri kreditor dhe në veçanti për të mbështetur sektorët më të pafavorizuar e që janë me rëndësi të madhe për zhvillimin e sektorit privat dhe në tërësi të ekonomisë së Kosovës.

## INVESTIMET E KAPITALIT


FKGK-ja deri në fund të vitit 2022 ka arritur që ndër vite të rritë kapitalin dhe në këtë mënyrë të prezantohet si institucion stabil në tregun financiar. FKGK-ja investon një pjesë të kapitalit të vet në institucionet partnere të FKGK-së, siç edhe specifikohet në ligj dhe në këtë mënyrë gjeneron të hyra nga interesi i fituar për të mbuluar shpenzimet operative. Të ardhurat nga investimet konsolidohen në Pasqyrën e të Ardhurave, ndërsa fitimi vjetor riinvestohet apo mbahet në FKGK, duke e rritur kapitalin, dhe nuk shpërndahet jashtë FKGK-së në asnjë formë apo mënyrë, duke i përfshirë edhe dividendët. FKGK-ja e reflekton besimin në institucionet partnere, duke lënë në menaxhim të tyre mjetet e investuara. Gjatë planifikimit për investime, FKGK-ja kujdeset që të ofrojë likuiditet në tregun financiar dhe rrjedhimisht një ndikim në rritjen e kreditimit nga ana e institucioneve financiare. FKGK-ja gjithashtu optimizon normat e kthimit nga investimet, gjithmonë duke u kujdesur që të ruajë stabilitetin në treg. Gjatë vitit 2022, FKGK-

ja ka investuar 41,840,832 euro në depozitat me afat me institucionet partnere financiare të FKGK-së, me maturitet njëvjeçar, dyvjeçar dhe trevjeçar, duke vazhduar kështu bashkëpunimin shumëvjeçar në këtë drejtim. Në vitin 2022, FKGK-ja ka investuar dhe në Letra me Vlerë të Qeverisë së Kosovës në vlerë prej 18,850,000 euro me maturitet trevjeçar dhe pesëvjeçar.






### DEPOZITAT ME AFAT SIPAS MATURITETIT



### LETRAT ME VLERË SIPAS MATURITETIT



FKGK-ja investon mjetet duke ndjekur parimet e ndarjes proporcionale sipas politikës së investimeve, ku investimet tek institucionet partnere financiare përbëjnë deri në 70% të total investimeve, ndërsa investimet në Letra me Vlerë të Qeverisë së Kosovës, 30%. Ndarja sipas maturitetit të investimeve ka një përbërje tjetër, ku 60% e investimeve janë me maturitet deri në njëzet e katër muaj dhe 40% e tyre me maturitet mbi njëzet e katër muaj deri në gjashtëdhjetë muaj. Prej investimeve me maturitet deri në njëzet e katër muaj, minimum 30% e tyre duhet të jenë me maturitet deri në dymbëdhjetë muaj.

Ndërsa prej investimeve me maturitet mbi njëzet e katër muaj e deri në gjashtëdhjetë muaj, minimum 20% e tyre duhet të kenë maturitet nga tridhjetë e gjashtë muaj deri në dyzet e tetë muaj. FKGK-ja në bazë të politikës, kujdeset që po ashtu të ketë diversifikim të investimeve tek institucionet partnere financiare. Sipas politikës janë përcaktuar limite të participimit deri në 25% për investime deri në njëzet e katër muaj, 22,5% participim për investime me mbi 70% deri në njëzet e katër muaj dhe 20% participim për investime të kombinuara ku 50% janë me maturitet deri në njëzet e katër muaj dhe 50% me maturitet deri në gjashtëdhjetë muaj.

## KAPITALI NGA DONATORËT



# QEVERISJA MJEDISORE DHE SOCIALE

Ndryshimet klimatike si dhe degradimi mjedisor janë pikat kyçe me të cilat po përballemi në këtë kohë. Për t'i adresuar këto çështje, Bashkimi Evropian ka hartuar Marrëveshjen e Gjelbër (The European Green Deal) e cila parasheh që deri në vitin 2050, emetimet nga gazet serrë të bien në zero si dhe të promovohet rritja e qëndrueshme. Këto politika do të aplikohen gradualisht dhe do të hyjnë në fuqi të plotë për pjesëmarrësit e tregut financiar për një periudhë më të gjatë kohore. Është thelbësore që të zhvillohen strategji, që të përgatitemi në mënyrë që të jemi në gjendje të përballemi me ndryshime të tilla, ngase sektori financiar pritet të luajë rol kryesor në financimin e tranzicionit të gjelbër dhe ekonomisë së qëndrueshme. Ky transformim sigurisht që do të nxisë mundësi të reja biznesi, por, njëkohësisht edhe sektori financiar do të ekspozohet ndaj rreziqeve financiare që rrjedhin nga transformimi i ekonomisë dhe përkeqësimi i kushteve fizike. Rëndësia e faktorëve të Qeverisjes Mjedisore dhe Shoqërore (QMS) për institucionet, varet jo vetëm nga aktivitetet e tyre biznesore, por edhe nga qeverisja dhe strategjia për menaxhim. Në këtë drejtim, institucionet mund të ndikohen në shkallë të ndryshme nga ndryshimet e politikave përgjatë rrugës së tranzicionit drejt një ekonomie të qëndrueshme mjedisore.

## MENAXHIMI I RISKUT MJEDISOR DHE SOCIAL

Menaxhimi i riskut mjedisor dhe social ndahet në dy komponentë: Vlerësimi i ndikimit mjedisor dhe

social nga aktivitetet e FKGK-së si dhe vlerësimi i ndikimit nga kreditë e garantuara. FKGK-ja si institucion garantues vlerëson rreziqet që lidhen me kreditë e garantuara. Kjo përfshin vlerësimin e ndikimeve mjedisore dhe sociale të operacioneve dhe identifikimin e rreziqeve të mundshme. Duke kryer vlerësime të plota të riskut, FKGK-ja vendos se cilat biznese t'i mbështesë dhe t'i drejtojë ata në zbatimin e masave zbutëse për të minimizuar ndikimet negative. Kjo lejon gjurmimin e progresit, identifikimin e fushave për përmirësim dhe sigurimin që bizneset t'u përmbahen angazhimeve të QMS-së. Duke u bazuar në këta faktorë, FKGK-ja ka ndërtuar një sistem që vlerëson ndikimin e kredive të garantuara në aspektin mjedisor dhe social duke marrë parasysh aspektet e QMS-së gjatë procesit të vendimmarrjes, në bazë të praktikave më të mira të mundshme dhe me ndikime më të vogla mjedisore dhe sociale. Për të vlerësuar ndikimin e brendshëm të FKGK-së, janë ndërmarrë masa që të reduktohen gjurmët e karbonit duke zvogëluar konsumin e energjisë elektrike, riciklimin e mbeturinave si dhe përdorimin e taksive elektrike për operacionet. Po ashtu, FKGK-ja ka realizuar trajnime rifreskuese me IRF-të dhe IMF-të në lidhje me çështjet mjedisore dhe sociale të kredive të financuara dhe të garantuara nga FKGK-ja. Një tjetër komponent i rëndësishëm është që është rifreskuar politika e menaxhimit mjedisor dhe social sipas kërkesave të donatorëve. Me këtë rifreskim, FKGK-ja ka kufizuar listën e sektorëve dhe aktivitetëve që garantohen, duke marrë për bazë ndikimin mjedisor dhe social që mund të shkaktohet.


## GROW

Sektori energjetik i Kosovës, kryesisht i dominuar nga thëngjilli, është ndikuar nga rritja e kërkesës




dhe e çmimeve të energjisë elektrike, mungesa e diversifikimit të prodhimit të energjisë, humbja e energjisë nga transmetimi, kostot mjedisore dhe ekonomike që rezultojnë nga emetimet e gazeve serrë. Furnizimi i sigurt dhe i besueshëm me energji është thelbësor për të ardhmen e Kosovës për zhvillimin e sektorit privat, rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës. Si një kandidat potencial për anëtarësim në BE, nevoja për energji të sigurt dhe të qëndrueshme në Kosovë është edhe më e theksuar. Analiza e industrisë sugjeron se mënyra më efektive për Kosovën për të mbështetur kërkesat e saj të ardhshme për energji është të rrisë burimet e saj të ripërtëritshme të energjisë dhe të investojë intensivisht në efikasitetin e energjisë. Qëllimi i Dritares së Mundësive për Rimëkëmbje të Gjellbër (GROW) është të mbështesë sigurimin e financimit për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) për të përballur efektet e pandemisë Covid-19, veçanërisht duke mbështetur investimet e NMVM-ve në efikasitetin e energjisë, efikasitetin e burimeve dhe energjinë e ripërtëritshme. Kjo do të kontribuojë në promovimin e punësimit nga NMVM-të në Kosovë dhe në përmirësimin e produktivitetit dhe konkurrencës së tyre në mënyrë të qëndrueshme, duke kontribuar kështu në një "Rimëkëmbje të Gjellbër" nga pandemia.

Duke i garantuar kreditë në këtë dritare, FKGK-ja ka pasur ndikim pozitiv në aspektin mjedisor duke ndihmuar në shmangie të rreth 5000 ton CO2 gjatë



vitet. Duhet të theksohet që investimet në energjinë e ripërtëritshme mundësojnë që periudha e kthimit të investimit bëhet në një afat kohor brenda gjashtë vitesh, gjë që e bën këtë industri më atraktive për NMVM-të. Marrë parasysh që Kosova ka rreth 250 ditë me diell, investimet në këtë industri do të luajnë rol që varësia ndaj thëngjillit të zvogëlohet si dhe të synohet që të arrihen caqet e caktuara nga burimet e ripërtëritshme të energjisë. Në këtë kontekst, FKGK-ja do të përkrahë NMVM-të për të implementuar projekte që synojnë të zvogëlojnë faturat e energjisë elektrike si dhe të kontribuojnë në mbrojtje të mjedisit.



Gjatë vitit 2022, kanë qenë disa raste të cilat janë kategorizuar me risk të lartë. Plani investiv i këtyre garancioneve ka qenë për ndërtim të objekteve afariste. Kreditë që kanë për qëllim ndërtimin e objekteve afariste gjithmonë kategorizohen me risk të lartë për shkak që ndikimi mjedisor dhe social është më i lartë pasi shfrytëzohen më shumë

burime. Një tjetër aspekt që merret parasysh është edhe gjenerimi i mbeturinave ndërtimore. Këto raste janë monitoruar gjatë fazës së ndërtimit dhe është vlerësuar nëse masat e parapara për zvogëlim të ndikimit mjedisor dhe social janë marrë sipas rregulloreve dhe ligjeve në fuqi.

## NDIKIMI NË GJURMËT E KARBONIT TË GARANCIONEVE

Matja e emetimeve të lidhura me aktivitetet financiare është pika fillestare për institucionet financiare për të menaxhuar rrezikun dhe për të identifikuar mundësitë që lidhen me emetimet e gazeve serrë si dhe ndryshimet që duhen bërë për të zvogëluar këtë ndikim. Gjatë këtij viti, FKGK-ja ka filluar që ta masë ndikimin në gjurmët e karbonit në bazë të portofolit të garantuar. Pasi ky komponent është ende në pikën fillestare dhe jemi

duke i analizuar informatat, është e rëndësishme të theksohet që për këtë raport, rezultatet bazohen në të dhënat më të mira që janë në dispozicion, si dhe në mesataren e sektorit, por jo domosdoshmërisht reflektojnë ndikimin e garancive të FKGK-së.

Ndikimi llogaritet duke marrë për bazë portofolin aktiv të FKGK-së sipas sektorëve; asetet totale në atë sektor dhe emisioneve (emetimeve) të CO<sub>2</sub>. Më poshtë është paraqitur mënyra e kalkulimit e ndikimit në mjedis të FKGK-së.

$$\text{Total CO}_2 \text{ emisionet} = \text{Shuma outstanding} \times \frac{\text{CO}_2 \text{ emisionet/sektor}}{\text{Asetet totale}}$$

Standardi më lart kashërbyer përtë kalkuluar ndikimin e garancioneve të FKGK-së në mjedis. Kjo metodë është përdorur pas konsultimeve me "Partnership for Carbon Accounting Financials (PCAF)". PCAF është një partneritet mes institucioneve financiare që punojnë së bashku për të zhvilluar dhe zbatuar një metodologji për identifikimin e ndikimit të kredive në emetimet e gazeve serrë. Llogaritja

është bërë për 16 sektorë për të cilat të dhënat për emetimet e CO<sub>2</sub> ishin në dispozicion. Në bazë të kalkulimeve është vlerësuar që, FKGK-ja për rastet e garantuara ka ndikuar me rreth 1.81 kiloton CO<sub>2</sub> në mjedis. Kreditë e garantuara në sektorët e bujqësisë dhe të prodhimitarisë kanë ndikim më të madh sa i përket lirimit të gazeve serrë.



## INFORMATA MBI ENERGINË

Konsumi i energjisë tregon shpenzimet e energjisë elektrike për ngrohje, ftohje si dhe veprimet ditore të zyrës. Në krahasim me vitin 2021, FKGK-ja gjatë vitit 2022 shpenzoi rreth 2 mWh energji elektrike më pak, duke ndikuar indirekt në gjurmë të karbonit me rreth 163 tonë CO<sub>2</sub>. Duke marrë parasysh krizën energjetike, kemi implementuar masat për kursimin e energjisë elektrike dhe si rrjedhojë kemi rezultatat e kursimit të shënuara më lart. Gjatë vitit 2022, është mbajtur trajnimi i brendshëm me stafin për çështjet mjedisore, me ç'rast janë paraqitur të gjithë komponentët që ndikojnë në shpenzim të energjisë elektrike si dhe masat që duhen ndërmarrë.

## SHTYPJA E LETRËS

Në krahasim me vitin paraprak, përdorimi i letrës është shtuar duke marrë parasysh që në këtë vit janë nënshkruar marrëveshje dhe kontrata të reja. FKGK-ja synon të minimizojë përdorimin e letrës, duke inicuar implementimin e nënshkrimit digjital. Ky mekanizëm do të shërbejë që institucioni ynë ta reduktojë deri në 70% përdorimin e letrës. Vlen

të theksohet që FKGK-ja riciklon letrat e përdorura duke zvogëluar ndikimin që ky aktivitet ka në mjedis. Në kuadër të fushatave vetëdijësuese, FKGK-ja e ka shndërruar në traditë që në përvjetorët e themelimit, angazhohet që përmes mbjelljeve të fidanëve të kontribuojë në mjedis, dhe në 2022-tën mbolli 12 drunj. Me këtë aktivitet, FKGK-ja ka ndikuar me rreth 250 kg CO<sub>2</sub> të absorbuar dhe njëherit ka shërbyer si një fushatë vetëdijësuese e cila do të vazhdojë edhe në vitet në vijim me iniciativa të tilla.

## MBETJET ELEKTRONIKE

Stafi i FKGK-së është vetëdijësuar në lidhje me ndikimin e mbetjeve elektronike në mjedis. Për këtë arsye, tonerët e printerave dhe bateritë rimbushen e riciklohen. Të gjitha mbetjet e tjera që nuk mund të ripërdoren, dërgohen në qendrat e posaçme për riciklim. Duke ricikluar këto pajisje, FKGK-ja luan rol në parandalimin e kontaminimit të tokës dhe të ujërave.





PJESA V



# VEÇORITË E VITIT 2022

# NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI I LIGJIT NR.05/L-057 PËR THEMELIMIN E FKGGK-së

Në vitin 2022, me rekomandim të FKGGK-së dhe propozim të Qeverisë, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore. Amendamenti i Ligjit të FKGGK-së krijoi bazën ligjore për mundësinë e rritjes së mbulueshmërisë kreditore deri në 80%, ofrimin e garancive kreditore për fermerët me numër identifikues të fermës të cilët nuk janë të regjistruar në ARBK, mundësinë e ofrimit të garancive kreditore në nivel të portofolit, të cilat elemente janë materializuar në marrëveshjet e veçanta të garancisë që FKGGK-ja ka nënshkruar me Institucionet e Regjistruara Financiare me qëllimin final të mbështetjes së Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme dhe sektorit privat dhe në këtë mënyrë në ndikimin e rritjes së punësimit dhe zhvillimit ekonomik në përgjithësi.

## DRITARJA E RIMËKËMBJES SË GJELBËR - GROW

Në ndërkohë që lufta në Ukrainë ka shkaktuar lëkundje në tregje dhe ngritje të çmimeve të energjisë elektrike dhe të gazit natyror, Kosova edhe pse burim kryesor e ka linjtin, po ashtu është ndikuar nga këto çmime, sidomos në stinën e dimrit kur konsumi është më i lartë dhe detyrohet të importojë energji elektrike nga vendet e tjera. Për ndërmarrjet kosovare, furnizimi i sigurt dhe i besueshëm me energji është thelbësor për të siguruar qëndrueshmëri dhe konsistencë në ofrimin e shërbimeve dhe produkteve në treg, e që më pastaj kjo do t'i sigurojë rritje, dhe pse jo, edhe depërtim në tregjet rajonale. Si një kandidat potencial për anëtarësim në BE, nevoja për energji të sigurt dhe të qëndrueshme në Kosovë është edhe më e theksuar.

Prandaj, FKGGK-ja propozoi Dritaren e re të Rimëkëmbjes së Gjellbër (GROW), lansimi i së cilës u mundësua nga bashkëpunim dhe mbështetja e përbashkët në mes të MCC/MFK dhe KfW.





Përmes garantimit kreditor të investimeve të gjelbra, qëllimi i dritares do të jetë promovimi i punësimit nga NMVM-të, dhe përmirësimi i konkurrueshmërisë dhe produktivitetit të NMVM-ve në mënyrë të qëndrueshme. Si rrjedhojë, të kontribuojnë në rimëkëmbjen ekonomike të ekonomisë nacionale, pas krizës nga pandemia, përmes investimeve të gjelbra. Kjo dritare garantuese, do të përmirësojë kushtet e financimit, në mënyrë që të rritet kredihënja, e që do të nxisë rritjen ekonomike, të zvogëlojë varshmërinë nga burimet fosile, si dhe të promovojë ruajtjen e energjisë. Kreditimi i mbështetur nga garancionet kreditore brenda Dritares GROW, mendojmë që do të arrijë të mobilizojë investime shumë të nevojshme në gjenerimin e energjisë fotovoltaike për vetkonsum për NMVM-të, duke investuar në projekte/pajisje që rrisin efikasitetin e energjisë.

Implementimi i kësaj dritareje do të bëhet në disa faza:

- faza e pilotimit filloi me ProCredit Bank në muajin qershor 2022;
- faza e dytë, implementimi i plotë i dritares së energjisë pritet të ndodhë gjatë pjesës së dytë të vitit 2023 me të gjitha IRF-të.

Përveç skemës garantuese kjo dritare do të ketë edhe komponentin e asistencës teknike me qëllim të rritjes së kapaciteteve të IRF-ve duke ofruar trajnime të përshtatura për stafin, që të orientojnë klientët drejt investimeve të gjelbra.

---

## DRITARJA E EKSPORTIT

Mundësitë e zhvillimit ekonomik përmes eksportit janë të shumta dhe Kosova përgjatë viteve ka treguar që ka potencial për të eksportuar produkte dhe shërbime me konkurrueshmëri të lartë. Vendndodhja e saj, kostoja e ulët e prodhimit, sistemi i favorshëm tatimor si dhe popullata e re janë përparësitë e ndërmarrjeve eksportuese për depërtim më të lehtë në tregjet ndërkombëtare, dhe në këtë mënyrë të jenë pjesë e hartës së furnizuesve.

Megjithatë, ndërmarrjet e përfshira në këtë segment shpeshherë ballafaqohen me vështirësi të natyrës së financimit duke filluar nga mungesa e qasjes në financa për shkak të mungesës së kolateralit, e deri te mungesa e mekanizmave të tjerë të financimit që i përshtaten natyrës së operimit, kjo për arsye se këto ndërmarrje shpeshherë konsiderohen si të vogla për bankat zhvillimore ndërkombëtare apo shumë riskoze për bankat komerciale. Duke e ditur rëndësinë e ndërmarrjeve eksportuese dhe nevojën që këto ndërmarrje mund ta kenë për të realizuar këtë potencial, që nga ditët e para të operimit është synuar të përkrahim këtë sektor.



Lidhur me këtë, në dhjetor të 2022-tës është lansuar Dritarja e Eksportit e cila në partneritet me bankat e vendit tonë, do t'u ofrohet bizneseve që merren me eksport si një mundësi e re, rrjedhimisht një akselerues dhe shtytës i bizneseve që krahas qasjes në financa, përmes Dritaresh së Eksportit të rrisin mundësitë dhe t'u hapen dyert për investime dhe plasim të produkteve e shërbimeve cilësore jo vetëm në Kosovë e rajon, por edhe më gjerë. Dritarja e Eksportit që kemi filluar ta pilotojmë me bankat partnere u dedikohet të gjitha ndërmarrjeve që me investimin e tyre planifikojnë të fillojnë plasimin e produkteve në tregjet e jashtme, apo ato që një pjesë të shitjeve të tyre tanimë e kanë të destinuar për eksport, ndërkaq me investimin e radhës planifikojnë të forcojnë dhe konsolidojnë edhe më shumë pozitën e tyre në tregjet ndërkombëtare. Ndërsa, risi te kjo dritare, janë kushtet më të favorshme, duke filluar nga mbulueshmëria më e lartë me garanci deri në 500K euro, rritja e vlerës së kredisë që mund të kualifikojë në këtë dritare deri në 3.0 milionë euro, e deri te mbulimi i humbjeve në tërësi bazuar në kapitalin e ri të siguruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës (QRK) përmes kredisë nga Banka Zhvillimore Evropiane (EBRD).

Kjo skemë do të mbështesë të gjitha investimet në kapital qarkullues apo edhe investimet në pajisje, teknologji e patundshmëri qëllimi i së cilave do të jetë mundësimi i bizneseve për të penetruar me cilësi të duhur në tregjet e huaja. E veçanta e kësaj dritareje është edhe komponenti jofinanciar i realizuar me mbështetje të USAID Kosovo Compete Activity e cila do të përkrahë FKGK-në që përmes asistencës teknike të pasurojë këtë dritare me karakteristika të tjera sipas nevojës së tregut si dhe të ngrisë vetëdijen e sektorit lidhur me mundësitë e financimit dhe mekanizmat e duhur financiarë për të mbështetur realizimin e investimeve. Përmes kësaj dritareje, FKGK-ja përveç se përmbush një objektivi mu të filleve të operimit, po ashtu do të jetë hallkë në zingjirin e këtij sukcesi që do të tejkalojë kufijtë kombëtarë.

## FILLOI IMPLEMENTIMI I PROJEKTIT ME BANKËN EVROPIANE PËR INVESTIME (EIB)

Një tjetër arritje e vitit 2022 është fillimi i zbatimit të marrëveshjes me Bankën Evropiane për Investime (EIB) të nënshkruar më 28 qershor 2021 ndërmjet EIB dhe Ministrisë së Financave të Kosovës. Kjo marrëveshje siguroi rritje të kapitalit për Fondin Kosovar për Garanci Kreditore i cili përmes skemave garantuese do të lehtësojë qasjen në financa për bizneset mikro, të vogla dhe të mesme, duke u mundësuar qasje në një burim më të favorshëm të financimit.

Gjatë muajit tetor 2022 filloi implementimi i Dritaresh Standarde përmes kapitalit nga EIB, që do të thotë që Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) përmes kësaj marrëveshjeje do të mbështesë bizneset mikro, të vogla dhe të mesme me më pak se 250 të punësuar, duke u mundësuar qasje në një burim të çmuar të financimit me kosto të ulët dhe me plan fleksibil të pagesës së kësteve të kredisë (rikthimit të pagesave).



# TË ARRITURAT E FKGK-së

DERI MË 31 DHJETOR 2022



**12,084**  
KREDI



**14%**  
GRA

PRONARE/  
BASHKËPRONARE



**611**  
MILIONË EURO

RRITJE E  
QARKULLIMIT



**506.3**  
MILIONË EURO

KREDI TË  
GARANTUARA  
NGA FKGK



**8,871**  
PËRFITUES

NDËRMARRJE MIKRO,  
TË VOGLA DHE TË MESME



**20,266**

VENDE TË  
REJA PUNE



# PJESA VI



# AKTIVITETET GJATË VITIT 2022

# LANSOHET DRITARJA GROW

**GROW** Green  
Recovery and  
Opportunity  
Window



**17 qershor 2022** – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) dhe partnerët lansuan dritaren e re të garancioneve bankare GROW – Dritarja e Rimëkëmbjes së Gjellbër, e cila do të mbështesë investimet e bizneseve kosovare në energji të ripërtërishme dhe efikasitet të energjisë. Projekti GROW i disenjuar dhe financuar nga Fondacioni i Milleniumit i Kosovës (MFK) dhe i përkrahur nga Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC), hapi sot fazën e dytë të projektit.

Falë kapitalit prej 6 milionë eurosh të dhuruara nga Qeveria Gjermane përmes Bankës Gjermane për Zhvillim KfW, dhe garancioneve shtesë të lëshuara nga agjencioni federal amerikan DFC, dritarja e re e implementuar nga FKGK-ja do t'i ndihmojë institucionet partnere financiare në kreditimin e sektorëve të cilët nuk janë shërbyer deri më tani. Si pjesë e fazës pilot, gjatë ceremonisë së lansimit të dritares, u nënshkrua marrëveshja me bankën ProCredit, si partneri i parë financiar i cili do të ofrojë këtë lloj shërbimi për klientët e tij. Së shpejti do të vijojë bashkëpunimi me institucione të tjera financiare në Kosovë.

# LANSOHET DRITARJA E EKSPORTIT



**Dhjetor 2022** – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore dhe USAID Kosovo Compete Activity, lansuan një dritare e re për lehtësim financiar “DRITARJA E EKSPORTIT” Përmes Dritares së Eksportit, do të mund të lëshohen garanci të reja për institucionet financiare partnere në dobi të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, veçanërisht për bizneset e fokusuara në eksport.

Në këtë aktivitet ishin të pranishëm përfaqësues të: Qeverisë së Republikës së Kosovës; Bankës Qendrore të Kosovës; USAID-it; Ambasadës Suedeze në Kosovë; Shoqatës së Bankave; Bizneseve nga sektoret e përpunimit të drurit, përpunimit të ushqimit, dhe Teknologjisë Informativë dhe Komunikimit (TIK); Donatorëve; Bankave Komerciale; Institucioneve Mikrofinanciare dhe shumë përfaqësues, partnerë dhe bashkpunëtorë të tjerë.

## MBAHET TRYEZA VIRTUALE - "PAKOJA E RIMËKËMBJES EKONOMIKE - REZULTATI DHE NDIKIMI"

**26 janar 2022** - Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK), organizoi tryezë virtuale "PAKOJA E RIMËKËMBJES EKONOMIKE REZULTATI dhe NDIKIMI" me ç'rast u prezantuan rezultatet e Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike si dhe të arriturat e FKGK-së gjatë vitit 2021.



## FKGK NËNSHKRUAN MARRËVESHJEN ME AGJENCINË PËR FINANCIM NË KOSOVË (AFK)

**9 mars 2022** - Fondi Kosovar për Garanci Kreditore nënshkruan Marrëveshjen me Agjencinë për Financim në Kosovë (AFK). Marrëveshja është nënshkruar për garantimin e kredive bujqësore në kuadër të Ddritares AGRO të FKGK-së. Kjo ngjarje shënon zgjerimin e mëtejshëm të marrëveshjeve mes FKGK-së dhe institucionet mikrofinanciare, duke ofruar garanci për kredi bujqësore dhe agrobiznese vendase. Dritarja Agro, është një skemë garantuese në kuadër të FKGK-së për të mbështetur fermerët dhe agrobizneset. Deri më tani, brenda këtij sektori janë rreth 11.4 milionë euro garanci aktive. Kapitali i përgjithshëm për dritaren AGRO ka arritur vlerën prej 11.5 milionë euro i cili financohet plotësisht nga Qeveria Gjermane, nëpërmjet Bankës Gjermane për Zhvillim - KfW.



## FKGK MBAN PUNËTORINË "AGRO WORKSHOP"

**15 mars 2022** - Fondi Kosovar për Garanci Kreditore mbajti punëtorinë "Agro Workshop" për banka dhe institucione mikrofinanciare partnere! Në këtë trajnim morën pjesë institucionet e regjistruara financiare. temat e trajnimit ishin: Zhvillimet në garantimin e agro kredive; Rritja/Rënia neto në agro portofolin e IF; Pjesëmarrja e Agro garantimit në Agro financim; Financimi i fermereve me NIF (participim sipas shumave); NPL në agro sektor; Claim-at e paguar; Garantimi i agro granteve.



## FKGK LANSON FUSHATËN DHE VIDEON PËR START UP-ËT

**22 mars 2022** – Lansohet fushata dhe video për StartUP - FKGK përkrahë idetë e reja dhe ndërmarrësinë! Fondi Kosovar për Garanci Kreditore përmes institucioneve financiare partnere, ofron bashkëpunim dhe mbështetje për bizneset StartUp.





## FKGK MBAN LIGJERATËN ME TITULL “ROLI I SKEMAVE GARANTUESE” NË RIT KOSOVO

**29 mars 2022** - Fondi Kosovar për Garanci Kreditore mban ligjeratën me titull “Roli i skemave garantuese” në RIT Kosovo, në klasën e profesor Fadil Sahiti. Kjo ligjeratë u organizua për studentët e degës menaxhment dhe biznes, me qëllim të njohjes me punën, kontributin, rezultatet, funksionin e FKGK dhe skemave garantuese në përgjithësi.



## FKGK MBAN LIGJERATËN ME TITULL “ROLI I SKEMAVE GARANTUESE” NË KOLEGJIN RIINVEST

**8 prill 2022** - Fondi Kosovar për Garanci Kreditore mban ligjeratën me titull “Roli i skemave garantuese” në klasën e profesor Gëzim Turkeshi në kolegjin Riinvest. Kjo ligjeratë u organizua për studentët e degës menaxhment dhe biznes, me qëllim të njohjes me punën, kontributin, rezultatet, funksionin e FKGK dhe skemave garantuese në përgjithësi.



## FKGK MBAN TRAJNIM ME STAFIN E AFK-së

**7 prill 2022** – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore mbajti trajnim me stafin e AFK – Agjencioni për Financim në Kosovë. Në fokus të trajnimit ishin roli i FKGK-së dhe Dritares Agro në veçanti, duke ju ofruar mundësinë e një përfshirje sa më të madhe për financimin e fermerëve vendorë. Ndër të tjera, stafi i AFK-së, u trajnuar edhe për Sistemin e Menaxhimit Mjedisor dhe Social.



## FKGK NË PUNËTORINË “KEY ACCOUNT MANAGEMENT” TË ORGANIZUAR NGA OEGJK

**21 prill 2022** – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore në punëtorinë “Key Account Management” të organizuar nga OEGJK, trajnim që u mbajt nga z. Kastriot Këpuska, Agro Expert nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore. Punëtorinë “Key Account Management” është një hap i rëndësishëm në rrugën drejt diferencimit, optimizimit të rezultateve të biznesit dhe rritjes së sigurt të të ardhurave. Gjatë kësaj punëtorie u diskutuan tema të ndryshme si: Bashkëpunimi me institucionet financiare (bankat dhe MFI), procesi Due Diligence, sinkronizimi i objektivave, procesi i ndarjes së limiteve, negocimi i kontratave me këto institucione financiare, rëndësia e relacionit formal dhe joformal për komunikim sa më efektiv. Trajnimi i stafit të këtyre institucioneve partnere, transmetimi i kushteve dhe kërkesave të donatorëve të institucioneve partnere; Pranimi dhe diskutimi i rasteve të garantuara; Kërkesat për produkte të reja, etj

## FKGK MBAN LIGJERATËN “ROLI I SKEMAVE GARANTUESE” NË UBT

**22 prill 2022** – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore gjatë ligjeratës së mbajtur me titull “Roli i skemave garantuese” në klasën e profesor Shpresim Vranovci në Institucionin e edukimit të lartë – UBT. Kjo ligjeratë u organizua për studentët e degës menaxhment dhe biznes, me qëllim të njohjes me punën, kontributin, rezultatet, funksionin e FKGK dhe skemave garantuese në përgjithësi.



## FKGK MBAN LIGJERATËN “ROLI I SKEMAVE GARANTUESE” NË AAB

**22 prill 2022** – Në kuadër të Javës Botërore të Kreativitetit dhe Inovacionit, FKGK mbajti ligjeratë për studentët e Fakultetit Ekonomik. Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) mbajti ligjeratë në Kolegjin AAB me temën “Roli i skemave garantuese”. Ligjeratën për studentët e zhvilloi z. Alban Kastrati, Menaxher i Lartë i Riskut. Ai shpalosi rolin e FKGK në financimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) në ekonominë e Kosovës, sidomos në ata sektorë që bankat komerciale hezitojnë të ndërmarrin rrezik financiar, si në bujqësi, start-up-e, kredi për biznese të grave, kredi për ekonomi të gjelbër etj.



## FKGK SHËNON GJASHTË VJETORIN E THEMELIMIT - JAVA E FONDIT

**Maj 2022** - U shënua java e FKGK-së me rastin e 6-vjetorit të themelimit të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore. U organizuan disa aktivitete gjatë javës së dytë të muajit maj: Ligjërata në UP; Intervistë në Radio Kosovë; "Brunch" për bashkëpunëtorë. Është bërë traditë e FKGK-së që të iniciojë aktivitetin e mbjelljes së drunjve me qëllim të krijimit të hapësirave të gjelbra. Me këtë rast, stafi i FKGK-së i mbolli dymbëdhjetë drunj bliri në oborrin e Shkollës së Mesme Ekonomike në Fushë Kosovës, në koordinim me Komunën e Fushë Kosovës.



## FKGK PREZANTOHET NË INTERVISTËN E INDEP

**Maj 2022** – FKGK-ja, është bërë pjesë e intervistës së organizuar nga INDEP, për të diskutuar mbi zbatimin e "Pakos së Ringjalljes". Si vazhdim i aktiviteteve të cilat mëtojnë të ngrisin vetëdijen rreth "Pakos së Ringjalljes Ekonomike", të aprovuar në korrik të vitit 2021, Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) ftoi në diskutimin e radhës, Drejtorin Menaxhues të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, z. Besnik Berisha.

## FKGK PUBLIKON DOKUMENTARIN PËR START-UP

**15 Korrik 2022** – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore publikoi dokumentarin për bizneset "StartUp". Cilat janë programet që ofrohen për "StartUp" në Kosovë? Çfarë mbështetje kanë ndërmarrësit e rinj? Me çfarë sfida ballafaqohen ata? A kanë qasje në financa? Pjesë të dokumentarit ishin përfaqësues nga banka TEB ShA si dhe Venture UP të cilët kontribuan në realizimin e dokumentarit, si dhe përfaqësuesja e FKGK-së, znj. Nora Arifi.

## FKGK PJESË E FORUMIT TË SOLARËVE 2022

**21 Korrik 2022** – FKGK-ja merr pjesë në Forumin e solarëve në Kosovë, prezanton Dirtaren GROW si dhe aktivitetet e FKGK-së.



## NËNSHKRUHET MEMORANDUMI I MIRËKUPTIMIT PËR DRITAREN E EKSPORTIT

**20 Gusht 2022** – USAID Kosovo Compete dhe Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, së bashku do të krijojnë dritaren e eksportit, një dritare e re garantuese që do të përkrahë qasjen në financa për eksportuesit kosovarë. Ky është një hap i madh i prezantimit të formave të reja të financimit në sektorin privat.

## FKGK FILLOI KAMPANJËN PËR DRITAREN STANDARDE

**Dhjetor 2022** – FKGK është duke implementuar Dritaren Standarde përmes kapitalit të Bankës Europiane për Investime (EIB), sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet EIB dhe Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës.

Kjo dritare gjithëpërfshirëse do të lehtësojë qasjen në financa për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) si dhe financim më të favorshëm.



## FKGK MERR PJESË NË NGJARJEN VJETORE TË AECM-SË

**Shtator 2022** - Ekipi përfaqësues i FKGK-së i përbërë nga: Rinor Gjonbalaj- Kryesues i Bordit; Besnik Berisha- Drejtor Menaxhues dhe Vjosa Balaj- Menaxhere e Lartë e Financave ishin pjesëmarrës në ngjarjen më të madhe vjetore të AECM- Shoqata Evropiane e Institucioneve Garantuese në Vjenë. Fokusi i këtij viti ishte financimi i qëndrueshëm për NMVM-të dhe Startup-ët. FKGK u prezantua në panelin e titulluar "Të bëjmë NMVM-të të përshtatshme për të ardhmen".



## VAZHDON FUSHATA E DRITARES GROW

**Shtator 2022** – GROW - Dritarja e rimëkëmbjes dhe mundësive të gjelbra! Kjo dritare që u lansua në qershor të vitit 2022, do të mbështesë investimet e bizneseve kosovare në energji të ripërtërishme dhe efikasitet të energjisë. FKGK - Fondi Kosovar për Garanci Kreditore lansoi dritaren GROW dhe në fazën pilotuese nënkroi marrëveshjen e parë me ProCredit Bank. Së shpejti do të nënshkruajë marrëveshje edhe me bankat tjera partnere. Gjatë shtatorit vazhdoi fushata dhe promovimi i dritares GROW në media të ndryshme digjitale dhe tradicionale.

## GJASHTË VITE NGA MIRATIMI I GARANCISË SË PARË TË FKGK-SË

**Shtator 2022** – Sivjet u bënë gjashtë vite nga miratimi i garancisë së parë kreditore. Përmes garantimit të kredive, Fondi ka ndikuar në përmirësimin e performancës së NMVM-ve me investimet e bëra nga kreditë e garantuara dhe ka lehtësuar qasjen në financa duke ndihmuar kështu zhvillimin e ekonomisë. Fondi Kosovar për Garanci Kreditore gjatë këtyre viteve ka ndërtuar portofol i cili ka arritur vlerën kumulative të kredive të garantuara në 471,8 milionë euro; 252,7 milionë euro garancione të miratuara të shpërndara në total 11,500 kredi deri më 31 dhjetor 2022.

## RAPORTI I BE-SË PËR KOSOVËN, VLERËSON PUNËN E FKGK-SË

**Shtator 2022** – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore mirëpret raportin e publikuar për Kosovën nga Komisioni Evropian. Ky raport ka vlerësuar se në gjysmën e parë të këtij viti, përveç shumë aspekteve pozitive nga masat e ndërmarra në rritjen e vazhdueshme të qendrueshmërisë në sektorin financiar, rritja e garancive të dhëna nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) në kreditimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, ka ndikuar në zbutjen e ndikimit të krizës gjatë pandemisë Covid19.

## FKGK FILLOI IMPLEMENTIMIN E DRITARES STANDARDE ME KAPITAL TË EIB

**Tetor 2022** – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore fillon implementimin e Dritares Standarde përmes kapitalit nga Banka Evropiane për Investime (EIB). FKGK filloi implementimin e marrëveshjes me Bankën Evropiane për Investime (EIB) të nënshkruar më 28 qershor 2021 ndërmjet EIB dhe Ministrisë së Financave të Kosovës. Kjo marrëveshje siguroi rritje të kapitalit për Fondin Kosovar për Garanci Kreditore i cili përmes skemave garantuese do të lehtësojë qasjen në financa për bizneset mikro, të vogla dhe të mesme, duke u mundësuar qasje në një burim më të favorshëm të financimit.

## FKGK NË FORUMIN E SEKTORIT USHQIMOR

**Tetor 2022** – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore pjesë e panelit me temë: “Produktet financiare relevante ne sektorin e ushqimit” në Forumin e sektorit ushqimor. Me këtë rast u prezantua produkti më i ri i FKGK-së – DRITARJA STANDARDE dhe veçoritë e saj. Në panel FKGK u paraqit nga drejtori menaxhues z. Besnik Berisha.



## FKGK NË FORUMIN E PARTNERITETIT TË LIZINGUT TË PAJISJEVE

**Tetor 2022** – Lizingu financiar është mjet i vlefshëm që mund t'i ndihmojë kompanitë të ulin kostot e larta të investimit për blerjen e pajisjeve moderne të përpunimit në sektorët e përpunimit të ushqimit dhe drurit! Së fundmi, sesioni i tretë i Forumit të Partneritetit për Qiradhënien e Pajisjeve, i organizuar nga Aktiviteti Kosovo Compete i USAID-it, ofroi informacione thelbësore dhe histori suksesi për dhënien me qira të pajisjeve. Përfaqësuesit e kompanive të sektorit privat mësuan gjithashtu për dritaren e re të Fondi Kosovar për Garanci Kreditore për Eficiencën e Energjisë – GROW, dhe dritaren e Financave të Eksportit, të cilat ofrojnë mundësi më të mëdha dhe preferenciale financimi për NMVM-të e orientuara drejt eksportit, në të gjithë sektorët e zbatueshëm. Gjithashtu, Aktiviteti KESS i USAID-it informoi kompanitë për ofertën e tyre në diagnostikimin e eficiencës së energjisë për NMVM-të.



## FKGK PJESË E PANELIT NË KONFERENCËN E SHOQATËS SË BANKAVE

**Nëntor 2022** – “Rritja e prodhimit vendor dhe eksportit përmes lehtësimit të qasjes në financa për MSME” – ishte tema e diskutimit në panelin e organizuar nga Shoqata e Bankave të Kosovës, me rastin e shënimit të 20 vjetorit të themelimit. Me këtë rast pjesë e panelit diskutues ishte Kryesuesi i Bordit të FKGK z. Rinor Gjonbalaj.



# SESIONET ORIENTUESE PËR INSTITUCIONET E REGJISTRUARA FINANCIARE

**Dhjetor 2022** – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore pas lansimit të Dritares Standarde dhe Agro, inicoi ciklin e ri të sesioneve orientuese të dizajnuara për stafin e institucioneve të regjistruara financiare. Sesionet orientuese përmbajnë informata të rëndësishme rreth veçorive të Dritares Standarde (me theks të veçantë në komponentën e eksportit), Dritares Agro si dhe Sistemin e Menaxhimit Mjedisor e Social (SMMS). Sesioni i parë u mbajt me stafin e NLB bankës për të vazhduar me sesionet për Bankën Ekonomike; Banka për Biznes; Raiffeisen Leasing Kosovo; AFK, KEP, KRK and FINCA.



Ju sjellim momente nga sesion i mbajtur me stafin e Banka Ekonomike.



Ju sjellim momente nga sesionet e mbajtura me stafin e Bankës për Biznes BPB.



Ju sjellim momente nga sesionet e mbajtura me stafin e Raiffeisen Leasing Kosovë.



Ju sjellim momente nga sesionet e mbajtura me stafin e institucioneve mikrofinanciare: AFK - Agjencioni për Financim në Kosovë KEP Trust dhe KRK - Kreditimi Rural i Kosovës.

## FKGK PJESË E PANELEVE DISKUTUESE GJATË JAVËS GLOBALE TË NDËRMARRËSISË

**Dhjetor 2022** – Lehtësimi në qasjen në financa për eksport - produkt i ri financiar i Fondit të Garancisë Kosovo Credit, i zhvilluar nga USAID, u prezantua si pjesë e Javës Globale të Ndërmarrësisë. Ky produkt do të jetë i aksesueshëm për të gjitha SME-të e qëndrueshme me deri në 249 punëtorë, që operojnë në të gjithë sektorët e zbatueshëm, kryesisht në aktivitete të orientuara nga eksporti. Lehtësia e re Financiare dhe mekanizmat e tjerë financiarë u diskutuan gjatë ngjarjes së Eksportit dhe Financimit Fillestar të organizuar nga USAID Kosovo Compete Activity.



## FKGK NË AKADEMINË E BPB-SË

**Dhjetor 2022** – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, përfaqësuar nga z. Besnik Berisha, Drejtor Menaxhues - pjesë e panelit me rastin e përmbylljes së ciklit të dytë të Akademive të Biznesit nga BPB me ç’rast u prezantua Dritarja GROW dhe veçoritë e saj.





## STORIE SUKSESI

### METAL - IN PANELET SOLARE – INVESTIM I MENÇUR

Përpunimi i metaleve është industri e vështirë, këtë e përjetuam në një punishte me mbi 25 punëtorë, me shumë makina për përpunimin e hekurit dhe shndërrimin në tela metalike, të gatshme për nevoja të tregut. Një biznes që fillet i ka që nga viti 2011 ka arritur që produktet e veta ti plasojë jo vetëm në tregun vendor por edhe më gjerë, pra në vende të rajonit dhe Evropë. Pronari i këtij biznesi, z. Nexhmi Lahu, njohës i mirë i industrisë, me përvojë të gjatë në Fabrikën e Armaturës Ndërtimore (FAN) që u privatizua në vitin 2006, na shpjegoi filluesën e kësaj punëtore si dhe sfidat e shumta me të cilat përballet kjo industri.

Duke e vizituar vendpunishten nga pika e parë e pranimit të materialit për përpunim, tutje nëpër pikat e gjithë procesit hap pas hapi, krijuam përshtypjen se sa i rëndësishëm dhe njëherit edhe i vështirë është gjithë ky proces i punës. Kërkohej koncentrim gjatë gjithë kohës, sepse puna me metal është e vështirë dhe e rrezikshme njëkohësisht. Zhurma e madhe e makinave të punës, hapësira e gjerë, të jepnin ndjesinë e prodhimit dhe fabrikës së vërtetë. "Për mua, zhurma e makinave është muzika e mëngjesit, nëse nuk ndëgjohet kjo muzikë në mëngjes do të thotë kemi ndonjë problem dhe prodhimi nuk ka filluar" – tha z. Lahu derisa e vizituam në fabrikë, në zyren e tij.

